

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6145  
E enjte, 22 tetor 2020  
çmimi 0.40 €

## 1 770 raste aktive me Covid në Kosovë

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MINISTRJA E FINANCAVE, HYKMETE BAJRAMI, KA MBAJTUR TË MËRKURËN KONFERENCË TË JASHTËZAKONSHME PËR ZHDUKJEN E 2 MILIONË EUROVE NGA THESARI I SHTETIT

FAQE 2

# 'AVULLOHEN' 2 MILIONË EURO NGA THESARI I SHTETIT!

Policia e Kosovës ka arrestuar një person i cili dyshohet se së bashku me dy persona të tjerë, që janë në arrati, kanë keqpërdorur pozitën zyrtare duke transferuar mbi dy milionë euro nga Thesari i Shtetit. Sipas policisë, dyshohet se një pjesë e parave janë transferuar jashtë vendit. Në një konferencë për media, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka konfirmuar se kanë ndodhur katër transaksione të paligjshme në vlerën mbi dy milionë euro. Ajo ka thënë se paratë janë tërhequr prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe kanë kaluar te një operator ekonomik më 9 tetor

## HOTI: KEMI PAUZUAR APLIKIMIN NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE, POR JO PËRGATITJET

FAQE 3



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se Kosova ka paузuar aplikimin në organizata ndërkombëtare, por jo përgatitjet. Në interpelancën parlamentare të thirrur për moratoriumin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, kryeministri Hoti ka thënë se Kosova po koordinohet

me të gjithë partnerët për t'u siguruar që aplikimet e ardhshme në organizata ndërkombëtare të mos dështojnë. Ndërsa subjektet politike opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Hoti se me këtë veprim ka shkelur Kushtetutën e Kosovës

KRYEMINISTRË ARSYETON  
SHKARKIMET NË POLICI, ATK  
DHE DOGANË

### OPINION

EKSPERIMENTET E SHPENDIT  
ME KRYEQYTETIN JANË TË  
PAPRANUESHME! F. 11

Shkruan:  
Ferat SHALA



### AKTUALE

FILLON FUSHATA PËR  
MBËSHËTETJE TË SHËNDETIT  
MENDOR, KRIJOHET  
PLATFORMA PËR NDIHMË  
PA PAGESË F. 6

NISMA DHE AKR-JA ME  
GRUP TË PËRBASHKËT  
PARLAMENTAR, SHEF  
ENDRIT SHALA F. 6

### EKONOMI

ÇFARË NDODHI ME  
SHTESAT PËR FËMIJËT? F. 9

NËNSHKRUHET  
MEMORANDUMI ME QËLLIM TË  
ZHVILLIMIT TË MËTEJTMË TË  
TREGJEVE FINANCIARE F. 9



### SPORT

BALLKANI TREGON FUQINË NDAJ  
KAMPIONËVE, PRISHTINA  
MPOSHTI FERONIKELIN F. 16



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka mbajtur të mërkurën konferencë të jashtëzakonshme për zhdukjen e 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit

## 'Avullohen' 2 milionë euro nga Thesari i Shtetit!

Policia e Kosovës ka arrestuar një person i cili dyshohet se së bashku me dy persona të tjerë, që janë në arrati, kanë keqpërdorur pozitën zyrtare duke transferuar mbi dy milionë euro nga Thesari i Shtetit. Sipas policisë, dyshohet se një pjesë e parave janë transferuar jashtë vendit. Në një konferencë për media, ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka konfirmuar se kanë ndodhur katër transaksione të paligjshme në vlerën mbi dy milionë euro. Ajo ka thënë se paratë janë tërhequr prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe kanë kaluar te një operator ekonomik më 9 tetor



### "Epoka e re"

PRISHTINË, 21 TETOR - Një punëtor i Thesarit të Kosovës dyshohet se ka bërë transferimin e 2,077,995 milionë eurove përmes katër transaksioneve të ndryshme, në adresë të një kompanie. Policia ka njoftuar zyrtarisht se të martën në mbrëmje, pas hetimeve të zhvilluara, është arritur të arrestohet një i dyshuar derisa dy të tjerë gjenden në arrati. Zyrtarisht është konfirmuar kërkimi i bllokimit të llogarive

pasi që dyshohet se një pjesë e parave janë transferuar jashtë vendit. Me urdhër të prokurorit i dyshuari është dërguar në mbajtje. Ky rast është thënë se ka ndodhur më 9 tetor 2020, ndërkaq arrestimi i parë është bërë më 20 tetor. "Më 20.10.2020 23:35, pas hetimeve të zhvilluara, është arritur të arrestohet një i dyshuar m/k dhe dy të tjerë gjenden në arrati. Të dyshuarit dyshohet se duke keqpërdorur detyrën zyrtare, duke përdorur thesarin shtetëror të Republikës së Kosovës, kanë transferuar para në vlerë

2.077.995.90 milionë euro. Është kërkuar bllokimi i llogarive pasi që dyshohet se një pjesë e parave janë transferuar jashtë vendit. Janë bërë bastisje të shtëpive të të dyshuarve, nuk është gjetur asgjë, vetëm është konfiskuar një veturë pronë e njërit nga të dyshuarit. Me urdhër të prokurorit i dyshuari është dërguar në mbajtje", thuhet në njoftimin e policisë. Në një konferencë për media edhe ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka konfirmuar se kanë ndodhur katër transaksione të

paligjshme. Ajo e ka cilësuar këtë rast si "të izoluar". Bajrami në një konferencë të jashtëzakonshme për media ka thënë se rastin në organet e rendit e ka denoncuar Ministria e Financave. "Ky është një transaksion bankar dhe kemi gjurmuar të gjitha transaksionet që janë bërë si rezultat i këtij transaksioni. Organet e rendit janë duke u marrë, për të parë se kush janë përfutuesit fundorë", ka deklaruar ajo. Ajo ka thënë se paratë janë tërhequr prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe kanë kaluar te një operator

ekonomik më 9 tetor. Bajrami ka thënë se buxheti është i sigurt dhe janë duke u hetuar të gjitha transaksionet. "Deri më tani janë suspenduar dy zyrtarë, një është arrestuar. Ne e kemi njoftuar edhe AKI-në. Ne kemi gjurmuar, ky është një transaksion bankar. Pra, i kemi gjurmuar të gjitha transaksionet të cilat janë përfutuese. Kemi bërë të gjitha kontrollet e nevojshme. Nuk është tërheqje e mjeteve kesh, por përmes transaksioneve", ka thënë ministrja Bajrami, duke shtuar se mjetet dhe buxheti i Kosovës është stabil.

## Veseli takohet me drejtueset e Shoqatës së Grave të Dëshmorëve: PDK-ja do të jetë përherë shtëpia e tyre



PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka pritur në takim udhëheqëset e Shoqatës së Grave të Dëshmorëve. Me këtë rast, Veseli ka theksuar se PDK-ja do të jetë përherë shtëpia e tyre. "Sot në zyrë prita udhëheqëset e Shoqatës së

Grave të Dëshmorëve, e themeluar së fundi nga bashkëshortet e dëshmorëve, Selver Maqkaj, Bedrush Gashit dhe Skender Latifit. Më gëzoi fakti që këto zonja të hekurta, me gjithë sfidat e vështira të jetës këto njëzet vjet, kanë vendosur të bëhen bashkë për t'i përfaqësuar e mbrojtur e promovuar

interesat e kësaj kategorie të ndjeshme të shoqërisë sonë. Premtova mbështetje dhe i sigurova se PDK-ja do të jetë përherë shtëpia e tyre, sepse e ka për obligim që t'u dalë në ndihmë familjeve që dhanë më të dashurit e tyre për lirinë e Kosovës", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

## Së shpejti port turistik në Sarandë, Durrës dhe Vlorë

TIRANË, 21 TETOR - Kryeministri Edi Rama në një konferencë për media ka folur për infrastrukturën kombëtare rrugore, portuale, aeroportuale dhe për planin 28 miliardë euro të Bashkimit Evropian për rajonin në infrastrukturë, energji dhe digitalizim. Rama ka folur për punën që po bëhet

për aeroportin e Kukësit dhe se është drejt përfundimit. Gjithashtu, Rama është shprehur se po punohet për nisjen e procesit të ndërtimit të aeroportit të Vlorës që u ndërpre për shkak të pandemisë. Kryetari i mazhorancës ka folur edhe për ndërtimin e

aeroportit të Sarandës dhe portit të ri të Durrësit. I pari port, që sipas kryeministrit do të nisë së shpejti, është ai i Sarandës, për të cilin Rama tha se kanë marrë një propozim fantastik. "Gjithashtu, edhe porti i Durrësit do të ketë një investim të madh në një ndryshim rrënjësor dhe do të

jetë puna më e madhe e bërë nga shteti dhe shumë shpejt do ta fillojmë procesin për portin e ri që ndodhet në një zonë ekonomike mjaft të favorshme dhe deri tani kemi shumë kërkesa. Po kështu do të bëjmë dhe me Vlorën, porti ekzistues është në infrastrukturë", ka thënë Rama.



# Hoti: Kemi pauzuar aplikimin në organizata ndërkombëtare, por jo përgatitjet



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se Kosova ka pauzuar aplikimin në organizata ndërkombëtare, por jo përgatitjet. Në interpelancën parlamentare të thirrur për moratoriumin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, kryeministri Hoti ka thënë se Kosova po koordinohet me të gjithë partnerët për t'u siguruar që aplikimet e ardhshme në organizata ndërkombëtare të mos dështojnë. Ndërsa subjektet politike opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Hoti se me këtë veprim ka shkelur Kushtetutën e Kosovës

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 TETOR - Opozita e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës se ka hequr dorë nga aplikimi për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare me marrëveshjen e Uashingtonit. Në interpelancën parlamentare të thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje, lidhur me pezullimin e aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, deputetët e LV-së dhe të PDK-së kanë vlerësuar se me këtë veprim qeveria ka shkelur Kushtetutën e Kosovës. Mirëpo kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i ka mohuar pretendimet e opozitës. Ai ka deklaruar se pavarësisht pajtimit që Kosova ta pezullojë për një periudhë njëvjeçare aplikimin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, ajo nuk i ka pauzuar përgatitjet për

këtë çështje. "Ne po vazhdojmë koordinimin e plotë me të gjithë partnerët dhe partnerin tonë - Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që të sigurohemi se aplikimet tona në organizata ndërkombëtare nuk dështojnë, siç ka ndodhur në të kaluarën, por rezultojnë me pranim dhe fuqizim të subjektivitetit tonë ndërkombëtar", ka thënë Hoti. Ai ka vlerësuar se moratoriumin për anëtarësim në organizata ndërkombëtare e ka bërë në koordinim me ShBA-në. "Pavarësia e Kosovës si dhe njohjet ndërkombëtare dhe anëtarësimi janë koordinim i ngushtë sistematik në partnerin tonë, pra me ShBA-në. Vetëm kështu ka qenë e mundur të rritet subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës dhe çdo aplikim për në organizatat ndërkombëtare të jetë i suksesshëm. ShBA-ja gjendet në krye të listës së partnerëve tanë në këtë drejtim, që kanë

përkrahur dhe sponsorizuar anëtarësimin e Kosovës", ka deklaruar Hoti.

Por deputetja e LV-së, Fitore Pacolli, ka deklaruar se kryeministri Hoti me vullnetin e tij të lirë dhe në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është zotuar se do ta pezullojë të drejtën legjitime të shtetit të Kosovës. "Pse të shpenzojë para dhe energji Serbia për ta bllokuar Kosovën përmes lobimit dhe angazhimit të saj diplomatik, kur Kosova e bllokoi veten me dëshirën e saj? Serbia e kupton shumë mirë rëndësinë e angazhimit të shteteve në institucione multilaterale, prandaj del me një kërkesë të tillë", ka deklaruar Pacolli.

Ndërsa deputeti i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka deklaruar se moratoriumi nuk është temë që ka rënë prej qiellit e duhet të fshihemi prapa marrëveshjeve.

Sipas tij, moratoriumi është zinxhir i ngjarjeve të koalicionit LV-LDK që e ka sjellë këtë situatë. "Ky është ai vizioni i shpresës, që edhe unë duke qenë gjatë në qeveri, e kemi kultivuar, por në situatën në të cilën jemi është më serioze se sa mund të mendojmë. Kemi pasur pritje që vera e vjeshta mund të jetë faza e fundit e dialogut, deri te marrëveshja e Uashingtonit, por gjërat nuk po shkojnë kështu. Ju kisha lutur të mos i besojmë këtij iluzioni, se s'ka të bëjë me atë kush është në qeveri, apo në opozitë, por ky iluzion mund ta dëmtojë vendin. Këto tri interpelanca që janë thirrur, realisht e kanë një emërues të përbashkët, një hegjemoni të re serbe në raport me Kosovën dhe rajoni dhe mendoj se kjo kërkon përgjigjen tonë si deputetë, e jo të flasim për dialogun siç kemi folur ndoshta para 10 vjetëve, pasi tani është situatë krejt tjetër", ka thënë Hoxhaj.

Vendosja e një moratoriumi të anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare është paraparë në marrëveshjen e 4 shtatorit në Uashington. Një ndër pikat e kësaj marrëveshjeje është që Kosova të mos kërkojë anëtarësim të ri në organizata ndërkombëtare për një vit, ndërsa Serbia, për të njëjtën

periudhë kohore, ta ndalojë fushatën për çnjohje të Kosovës. Serbia që nga viti 2017 ka bërë fushatë agresive diplomatike për tërheqjen e njohjeve të shtetit të Kosovës. Për shkak të lobimit të saj, disa shtete thuhet se i kanë ngrirë raportet e bashkëpunimit me Kosovën.

Fushata e Serbisë ka penguar që Kosova të anëtarësohet në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) dhe në Agjencinë për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara (UNESCO). Përveç INTERPOL-it dhe UNESCO-s, Kosova nuk është anëtare as e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Organizatës Botërore të Tregtisë, Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Deri më tani Kosova është anëtarësuar në shumë organizata të rëndësishme ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, Federata Botërore e Futbollit, Federata Evropiane e Futbollit, Komiteti Olimpik, Organizata Botërore e Doganave, Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA).

## Fushata për zgjedhjet në Mitrovicën Veriore do të jetë nga data 12 deri më 27 nëntor

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që fushata zgjedhore në Mitrovicën Veriore të jetë nga data 12 nëntori deri

më 27 nëntor, ndërsa për zgjedhjet në Podujevë do të diskutohet të enjten për të parë se a do të përsëriten aktivitetet edhe një herë. Në mbledhjen e

së mërkurës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë vendim për miratimin e planit të buxhetit për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme

për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe buxhetit shtesë për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës.





Hapja e zyrës përfaqësuese e Ministrisë ruse të Mbrojtjes në Serbi ka nxitur reagime të shumta në Kosovë

# BËHET THIRRJE QË DIPLOMACIA E KOSOVËS TË VEPROJË NDAJ HAPJES SË ZYRËS RUSE NË SERBI

Njohësit e proceseve politike dhe të sigurisë janë shprehur të shqetësuar për hapjen e zyrës përfaqësuese të Ministrisë ruse të Mbrojtjes në Serbi. Ata kanë deklaruar se kjo duhet të

shërbejë si kambanë e fundit alarmi për institucionet e Kosovës. Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri dhe eksperti i sigurisë, Ramadan Qehaja, kanë vlerësuar se ndaj hapjes së kësaj

zyre diplomacia e Kosovës duhet të veprojë në drejtim të një ribashkërendimi me partnerët tanë për t'i informuar lidhur me lëvizjet e fundit në Serbi

**EPOKA E RE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 TETOR - Hapja e Zyrës e Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë në Serbi është pritur me shqetësim në Kosovë. Njohësit e proceseve politike dhe të sigurisë kanë bërë me dije se diplomacia e Kosovës duhet të reagojë ndaj këtij veprimi rus në rajon. Sipas tyre, hapja e kësaj zyre paraqet rrezik për destabilizimin e Kosovës. Ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri, ka vlerësuar se derisa Rusia po zbarkon në Serbi me

zyrën e saj të Ministrisë së Mbrojtjes, ShBA-ja tani duhet të hapë Zyrën e Departamentit të Mbrojtjes në Kosovë. "Rusia po zbarkon në Serbi me zyrën e Ministrisë së Mbrojtjes. Tani ShBA-ja duhet të zbarkojë në Kosovë me zyrën e Departamentit për Mbrojtje. Është koha që NATO ta kompletojë integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, për t'i parandaluar ambicinet gjeopolitike ruse në rajonin e Ballkanit", ka deklaruar Tahiri.

Me shqetësim hapjen e kësaj zyre e ka pritur edhe eksperti i çështjeve ushtarake dhe të sigurisë, Ramadan Qehaja. Ai ka thënë se hapja e zyrës ruse të mbrojtjes në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë, në fakt, përbën një hap të paramenduar të shtetit serb për të zbatuar një luftë speciale, por edhe për t'iu kanosur shteteve fqinje, në veçanti Kosovës. "Ajo bëhet në vazhdim të një veprimi të rrezikshëm të Serbisë e cila ka arritur të përgatisë dhe të krijojë

marrëdhënie partneriteti me Rusinë dhe Kinën e që përbën sfidë, para së gjithash, për vetë aleancën e NATO-s. Më konkretisht, rritja e armatimit të Serbisë ndërthen një kërcënim direkt për stabilitetin e rajonit dhe është në s'përputhje me pretendimet gjoja bashkëpunuese të lidershit aktual në Serbi për, kinse, arritjen e një paqe të qëndrueshme në rajon", ka deklaruar Qehaja. Sipas tij, kjo duhet t'i alarmojë institucionet e sigurisë së Kosovës.

"Zyrtarizimi i tillë i pranisë ushtarake ruse në Serbi duhet të shërbejë si kambana e fundit për institucionet tona që ta ngrehin gatishmërinë institucionale, në veçanti të atyre të sigurisë dhe t'i monitorojnë zhvillimet e fundit të cilat gjithsesi se kanë për qëllim nxitjen e destabilizimit në Kosovë dhe rajon. Diplomacia e Kosovës duhet të veprojë në drejtim të një ribashkërendimi me partnerët tanë për t'i informuar lidhur me lëvizjet e fundit në Serbi, të cilat

# Kryeministri arsyeton shkarkimet në Polici, ATK dhe Doganë

PRISHTINË, 21 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka arsyetuar vendimet e fundit për shkarkimet e udhëheqësve të institucioneve të sigurisë dhe ekonomisë në vend. Në një konferencë për media, të mbajtur të mërkurën, Hoti ka thënë se qeveria që ai udhëheq është e vendosur për, siç u shpreh, “kthimin e ligjshmërisë” teksa dha detaje lidhur me shkarkimin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, atij të Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj dhe Ibrahim Xhaka, i cili, deri të premten ushtronte funksionin e ushtruesit të detyrës së Drejtorit në Doganat e Kosovës. Vendimi për shkarkimin e Qalajt, Murtezajt dhe Xhakas, u bë me dije nga Qeveria e Kosovës më 16 tetor. Duke arsyetuar shkarkimin e Qalajt, Hoti citoi një raport mbi performancën e këtij të fundit, që ia ka dërguar kryeministrit ministri i Brendshëm.

Raporti, tha Hoti, “thekson qartë se drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës ka treguar performancë jo të kënaqshme në udhëheqjen, kontrollin dhe mbikëqyrjen e policisë, gjithashtu në menaxhimin dhe shpërndarjen e buxhetit të policisë”. Kryeministri Hoti ka thënë se Qalaj nuk ka përmbushur objektivin e luftimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve të rënda. Ai e kritikoi ish-drejtorin e Policisë së Kosovës edhe për menaxhimin e një aksioni në Karaçevë të Kamenicës ku u mbyllën kazinotë dhe u konfiskuan mallra të kontrabanduara. “Është vënë re edhe menaxhim jo i mirë i aksionit në Karaçevë, pavarësisht suksesit të arritur në atë aksion”, ka deklaruar Hoti, duke shtuar se më shqetësuese mbetet fakti se gjatë vitit 2019-2020, janë arrestuar 68 policë për vepra të ndryshme penale, ku 39 prej tyre janë policë kufitarë.

“Përkundër numrit kaq të lartë të arrestimeve brenda Departamentit të Policisë Kufitare, nuk është bërë asnjë ndryshim në menaxhmentin e lartë të këtij departamenti”, është shprehur Hoti. Qalaj deri më tani nuk është deklaruar lidhur me shkarkimin nga udhëheqësia e Policisë së Kosovës. Ndërkaq Hoti ka thënë se është dashur ta lirojë nga detyra Ilir Murtezajn, ish-drejtorin e ATK-së pasi, sipas kryeministrit, ai ka ndërmarrë “një varg veprimesh që përmbushin kushtet ligjore për lirin e tij nga detyra për shkak të paafësisë ose sjelljes së keqe”. Hoti argumentoi se Murtezaj ka miratuar rregulloren për organizimin e brendshëm të ATK-së në kundërshtim me ligjin, si dhe ka shpallur konkurs për tri pozita të zëvendësdrëjtorit të kësaj agjencie, por më pas, ish-zëvendësdrëjtorët nuk i ka sistemuar, dhe “të cilët i ka konsideruar tepricë”, tha

kryeministri. Murtezaj, sipas Hotit, ka bërë lëvizje të shpeshta të stafit që kanë shkaktuar “pakënaqësi të madhe duke degraduar zyrtarët e kësaj agjencie. Të gjitha këto shkelje janë konstatuar edhe në mendimin juridik të Avokatit të Popullit të datës 09.07.2020”, tha kryeministri i Kosovës. Kurse sa i përket shkarkimit të ushtruesit të detyrës së drejtorit të Doganave të Kosovës, Ibrahim Xhaka, Hoti ka thënë se në këtë institucion është hapur tashmë konkursi për drejtor dhe Xhaka ka aplikuar në këtë pozitë, prandaj ai është shkarkuar nga kjo pozitë, në mënyrë që ky institucion të udhëhiqet nga dikush që nuk është pjesë e konkursit derisa të zgjidhet drejtori i ri. Kryeministri Hoti në postin e ushtruesit të detyrës së drejtorit të përgjithshëm të policisë ka emëruar Samedin Mehmetin, në ATK ka emëruar Ekrem Hysenajn, ndërsa në Dogana Bajram Rexhën.



mod.gov.rs (Courtesy Photo)

në secilin variant janë edhe kundër interesave të partnerëve bilateralë kryesorë dhe NATO-s”, është shprehur ai, duke shtuar se Kosova nuk duhet ta ndalë rrugën e saj drejt anëtarësimit në NATO. “Pavarësisht prej situatës së krijuar lidhur me veprimet e lartcekura serbe, Kosova duhet, përveç përgatitjeve për vetëmbrojtje, ta vijojë aspiratën e saj për fuqizim më tutje të aleancës me aktorët perëndimorë si një vizion i vetëm i palëkundur në funksion të paqes dhe sigurisë në Ballkan dhe Evropë”, ka thënë Qehaja. Ministria e Mbrojtjes e Serbisë ka njoftuar të martën se ka nisur procedurën për hapjen e zyrës përfaqësuese të Ministrisë ruse të Mbrojtjes në përputhje me një marrëveshje midis Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Rusisë. “Qëllimi i krijimit të zyrës përfaqësuese të Ministrisë së Mbrojtjes së Rusisë është të ofrojë mbështetje dhe zgjidhje më të shpejtë të çështjeve që lidhen me ndihmën ushtarake-teknike, bashkëpunimin ushtarak dhe ushtarako-teknik, në përputhje me marrëveshjen e Qeverisë së Serbisë dhe të Qeverisë së Rusisë për bashkëpunimin ushtarako-teknik”, është thënë në njoftim. Aty, po ashtu, theksohet se marrëveshja është nënshkruar



në bazë të një pajtimi midis presidentëve të Serbisë dhe Rusisë, Aleksandar Vuçiq dhe Vladimir Putin. Ndërsa agjencia e lajmeve “Reuters” ka raportuar se Rusia e ka autorizuar Ministrinë e saj të Mbrojtjes ta hapë zyrën e saj në Serbi në bazë të një dokumenti të Qeverisë në Moskë. Muajin e

kaluar Serbia i ka pezulluar stërvitjet ushtarake me ushtritë e huaja për gjashtë muaj, duke thënë se ka pasur presion nga BE-ja për t’u tërhequr nga stërvitjet e përbashkëta me Rusinë dhe Bjellorusinë. Urdhri i qeverisë ruse për hapjen e zyrës në Serbi daton nga 15 tetori dhe është

nënshkruar nga kryeministri rus Mikhail Mishusti. Sipas saj, shefi i zyrës së propozuar do të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve ushtarake dhe teknike në lidhje me bashkëpunimin ruso-serb. Marrëveshja, pasi të nënshkruhet nga të dyja palët, do t’i japë një zyrtari rus në

Serbi të drejtën për t’i vizituar divizionet serbe që përdorin armë dhe pajisje ushtarake ruse, me kusht që ato të njoftohen paraprakisht dhe ta japin pëlqimin e tyre. Vitet e fundit Serbia ka blerë aeroplanë luftarakë MiG-29 nga Rusia, si dhe helikopterë, tanke dhe transportues të blinduar.

# 1 770 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë paraqitur 124 raste të reja me Covid-19 në vendin tonë. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe janë shëruar 49 persona, duke e çuar 14 836 numrin e përgjithshëm të të shëruarave. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 974 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 124 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i

rasteve pozitive është 17 263 raste nga 82 678 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 657 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 49 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 836 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 770", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas secilës komunë. "Rastet pozitive janë nga komuna: Prishtinë 72 raste, komuna Gjilan 9 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Prizren 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna



Obiliq 2 raste, komuna Pejë 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Viti 2 raste,

komuna Vushtrri 2 raste dhe komuna Lipjan 1 rast. Mbuloni gojën dhe hundën

me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja.

## Dega e PDK-së në Prizren: Qeverisja aktuale, larg përfaqësimit të interesave të qytetarëve



PRIZREN, 21 TETOR (ER) - Partia Demokratike e Kosovës, Dega në Prizren, ka thënë se qeverisja aktuale nga Mytahir Haskuka është larg përfaqësimit të interesave të qytetarëve. Sipas kësaj partie, mandati i kësaj qeverisje është karakterizuar me drejtorë të akuzuar.

Dega e PDK-së në këtë qytet ka bërë me dije se vazhdimisht ka ngritur shqetësime për modelin e qeverisjes lokale në Prizren. "Dikur e ashtuqajtura qeveria Haskuka, tani më as këtë epitet nuk mund ta mbajë. E degraduar dhe e përcjell me mostransparencë dhe e ndeshur rregullisht me

ligjin. Larg përfaqësimit të interesave të qytetarëve të Komunës së Prizrenit. Pa vizion, pa strategji të artikullimit të kërkesave të qytetarëve. E radhitur në fund tek të gjitha listat nga monitorues vendorë dhe ndërkombëtarë. Çdo ditë e më shumë, po shpërfaq humbje besimi dhe mungesë orientimi qeverisës", është thënë në reagimin e kësaj partie. Sipas PDK-së në Prizren, në gjysmën e parë të mandatit, gjysma e drejtorëve ish-in të akuzuar. "Pjesën e dytë të mandatit, janë zyrtarë e drejtorë të akuzuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Tani, zyrtarisht, janë

tre drejtorë aktualë, të pandehur me procese në prokurorinë themelore në Prizren. Në modelin e qeverisjes aktuale dhe të frustruar, po këndohet edhe më tej kënga e vjetër prej ish-drejtorëve të akuzuar, deri në drejtorët aktualë si të pandehur. Jemi të shqetësuar jo vetëm duke përfaqësuar si opozitë qytetarët që na besuan, por edhe ata që dikur shpresonin për ndryshime në qeverisjen lokale. Kërkojmë nga Mytahir Haskuka, që të ndërmarrë masa të menjëhershme, ndaj atyre që kanë tradhtuar besimin publik qytetar", thuhet në reagimin e PDK-së në Prizren.

## Fillon fushata për mbështetje të shëndetit mendor, krijohet platforma për ndihmë pa pagesë

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Profesorët dhe studentët e Universitetit të Prishtinës, përkatësisht Departamentit të Psikologjisë, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe Zyrën e Vullnetarëve të Kombeve të Bashkuara (UNV) në Kosovë, lansuan fushatën "Fol me mu për shëndetin mendor" e cila synon t'u ofrojë mbështetje nga kjo fushë qytetarëve tanë. Fokusi i fushatës është ofrimi i këshillave, kujdesit, resurseve dhe edukimit për mirëqenien e njerëzve të ndikuar përgjatë pandemisë së Covid-19. Duke qenë se shqetësimet e qytetarëve janë rritur ndjeshëm, posaçërisht stresi,

ankthi, ndjenja e izolimit, mungesa e socializimit dhe mirëqenia e përgjithshme, profesorët dhe studentët e departamentit të psikologjisë në UP kanë vlerësuar që ka shumë hapësirë për ndihmë dhe mbështetje ndaj personave të prekur nga këto pasoja, si dhe parandalimin që këto probleme dhe brenga të shkaktuara nga pandemia të mos bëhen edhe më serioze. "Të gjithë jemi prekur nga COVID-19 në një formë apo tjetrën; qoftë përmes infektimit direkt, qëndrimin në shtëpi, jetës larg familjes dhe miqve apo pasigurisë që na është krijuar për mirëqenie, punë apo edukim. Prandaj, e kemi vlerësuar që një fushatë



si kjo që po e fillojmë tani, është e domosdoshme për t'u dalë në ndihmë kujtdo që është prekur dhe ka nevojë për ndihmën tonë", ka thënë Aliriza Arënlju, drejtorësh e Departamentit të Psikologjisë

në Universitetin e Prishtinës. Fushata "Fol me mu për shëndetin mendor" përfshin një seri temash të shumta psiko-edukuese të ofruara nga profesorë të psikologjisë, si burime të konfirmuara për

edukimin e njerëzve që kanë brenga të ndryshme rreth shëndetit mendor, një linjë telefonike për ndihmë që është në dispozicion falas prej 11:00 - 22:00, uebfaqe e dedikuar për këshilla dhe resurse, si dhe një seri të videove informative për tejkalimin e problemeve të mundshme që lidhen me shëndetin mendor.

Në shendetimendor.org qytetarët do të mund të marrin këshilla për përmirësimin e shëndetit mendor, apo të mësojnë për aktivitetet rreth tejkalimit të problemeve me stresin, gjumin, frymëmarrjen, mendimet negative apo të ngjashme.

# Periudha e pandemisë, shkaktare e ndryshimeve afatgjata për burimet njerëzore



Kryesuesja e komitetit e Odës Amerikane për Burime Njerëzore, Donika Karaxha, menaxhere e rekrutimit të talenteve në Sutherland, ka thënë se pandemia ka sjellë në pah nevojën për ndryshime në veprimtaritë e burimeve njerëzore për përshtatje të menjëhershme me situatën, ndërsa ka theksuar nevojën për njohjen e regjistrimit elektronik të pushimeve

gjatë periudhës së pandemisë, ndërsa proceset e transformimit digjital janë përshpejtuar si rrjedhojë e izolimit. Duke folur mbi sfidat nga kjo situatë e paprecedentë, Ibraimi ka thënë se vështirësi të veçanta kanë qenë testimi dhe vlerësimi adekuat i kandidatëve nga distanca. Ndërsa, sipas tij, kjo mënyrë e punës, megjithëse proces i nevojshëm për situatën në të cilën ndodhemi, do të ketë ndikime negative afatgjata për shkak të mungesës së komunikimit verbal dhe aktivitetit social brenda kompanive.

madhore në kontrata. Arlinda Vllasolli, menaxhere e Departamentit të Burimeve Njerëzore në kompaninë "Trepfarm", ka thënë se një ndër sfidat më të mëdha me të cilat departamenti i saj është ballafaquar gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 ka qenë vendimmarrja në orët e vona nga ana e Qeverisë së Kosovës e cila ka lënë një hapësirë të vogël kohore për implementim të rregullave efikase brenda kompanisë. Vllasolli, gjithashtu, potencoi se marrë parasysh natyrën e veprimtarisë së

"Trepfarm", Departamenti i Prodhimit ka punuar me kapacitet të lartë, ndërsa ai administrativ ka punuar nga shtëpia. Ajo gjithashtu ndau disa nga masat parandaluese në fuqi brenda kompanisë, siç janë ristrukturimi i shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta për punëtorët, ndërprerja e përkohshme e kontaktit me palë të jashtme, si dhe matja e rregullt e temperaturës. Vllasolli ka deklaruar se shkëputja e kontratave të punëtorëve në "Trepfarm" ka qenë minimale.

**EPOKA  
ERE****Qendresa RAMA**

**PRISHTINE, 21 TETOR** - Përveç ndryshimeve të shumta që ka shkaktuar në ekonomi, pandemia Covid-19 ka ristrukturuar edhe mënyrën dhe lokacionet e punës, duke rritur rolin e teknologjisë në komunikim. Rrjedhimisht, departamentet e burimeve njerëzore brenda kompanive janë ballafaquar me nevojën për ristrukturim të strategjive të tyre të punës, për ta mbajtur produktivitetin e punëtorëve. Ndryshimet e implementuara në strategjitë organizative, risistemimi i stafit, si dhe transferimi i punëve nga distanca ishin disa prej pikave të diskutuara në forumin e radhës virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, mbi ndikimin e pandemisë në riorganizimin e burimeve njerëzore.

Kryesuesja e komitetit e Odës Amerikane për Burime Njerëzore, Donika Karaxha, menaxhere e rekrutimit të talenteve në Sutherland, njëherësh edhe moderatore e këtij forumi, ka thënë se pandemia ka sjellë në pah nevojën për ndryshime në veprimtaritë e burimeve njerëzore për përshtatje të menjëhershme me situatën, ndërsa ka theksuar nevojën për njohjen e regjistrimit elektronik të pushimeve.

Anita Kosumi-Ajeti, udhëheqëse e Departamentit të Burimeve Njerëzore në Bankën për Biznes (BPB), ka theksuar se një ndër sfidat kryesore me të cilat është përballur ky institucion ka qenë organizimi i atillë i punës që mundëson vazhdueshmërinë e aktiviteteve dhe shërbimit të klientëve si dhe motivimin e stafit përmes komunikimit të vazhdueshëm. Sipas saj, BPB-ja ka marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e shëndetit të të punësuarve, duke funksionalizuar edhe punën nga shtëpia, aty ku ka qenë e mundur. Në lidhje me këtë të fundit, Kosumi-Ajeti u shpreh se puna nga distanca ka theksuar dukshëm rëndësinë e komunikimit të brendshëm dhe rolin e udhëheqësisë së bankës në menaxhimin e ekipeve nga distanca.

Ajo, po ashtu, potencoi se masat parandaluese të implementuara nga institucionet shëndetësore kanë shërbyer jo vetëm për ngritjen e vetëdijesimit të klientëve rreth shfrytëzimit të shërbimeve elektronike bankare, por edhe si shtysë për avancimin e këtyre proceseve nga sektori bankar në përgjithësi.

Shkumbin Ibraimi, kryeshfexekutiv i kompanisë Mercurius Consulting, ka theksuar se shërbimet për rekrutim të stafit, sidomos në profilet e teknologjisë informative, kanë shënuar rritje

Më tutje, Ibraimi bëri thirrje për mirëkuptim në mes të punëtorëve dhe pronarëve të kompanive në rast të shkëputjes së kontratave. Vedat Hajdari, menaxher i Departamentit të Burimeve Njerëzore në kompaninë "HIB Petrol", ka potencuar se marrë parasysh natyrën e punës së kësaj kompanie, ku rreth 70 për qind e të punësuarve kanë kontakt me klientë, një sfidë mjaft e madhe ka qenë organizimi i veprimtarive të punës.

Hajdari, gjithashtu, ndau me pjesëmarrësit disa nga masat që janë implementuar në këtë kompani për ta evituar ndërprerjen e kontratave të punëtorëve, me ç'rast punëtorët më të rrezikuar nga virusi qoftë nga pozita e tyre në shërbim të klientit, apo nga aspektet personale shëndetësore janë dërguar në pushim mjekësor. Hajdari ka theksuar se brenda ligjit të punës ekzistojnë dispozita të cilat përcaktojnë dhe arsyetojnë mungesën në punë për shkak të situatave të tilla, por edhe largimin nga puna si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike të kompanisë. Sipas tij, çështje që duhet të adresohen janë mungesa e formalitetit në fuqinë punëtore si dhe përfshirja e forcës



## Nisma dhe AKR-ja me grup të përbashkët parlamentar, shef Endrit Shala

**PRISHTINE, 21 TETOR (ER)** - Koalicioni Nisma-AKR është bërë me grup parlamentar. Në fillim të seancës të mërkurën, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka njoftuar se Nisma dhe AKR-ja më 19 tetor kanë vendosur që ta formojnë grupin parlamentar të

përbashkët. "Ju njoftoj se në bazë të nenit 20 të rregullores së Kuvendit, më 19 tetor është formuar grupi parlamentar Nisma-AKR, me gjashtë deputetë", ka deklaruar Osmani. Kryetar i grupit parlamentar Nisma-AKR është zgjedhur Endrit Shala.

# Reçica: Do të jemi të pakompromis ndaj atyre që nuk respektojnë masat e sigurisë dhe shëndetit në punë

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Në kuadër të Javës Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë me kryeinspektorin e Inspektoratit Punës, Ekrem Kastrati, kanë vizituar të mërkurën një nga kantieret e ndërtimit të lartë në kryeqytet, ku dhe kanë biseduar nga afër me punëdhënësin dhe punëmarrësin, për ta parë nivelin e respektimit të masave të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

Ministri Reçica ka thënë se do të vazhdojnë që çdo ditë të jenë pranë secilit punëtor, për të parë se sa po respektohen të drejtat e tyre dhe sa po punohet për zbatimin e masave për ta mbrojtur jetën e tyre. "Ne do të vazhdojmë të jemi të pakompromis ndaj gjithë atyre që nuk respektojnë

këto masa", ka thënë ministri Reçica.

Ministri Reçica ka thënë se duhet vlerësuar përparimin e arritur deri më tani lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, pavarësisht që nuk kanë arritur aty ku kanë dëshiruar. Gjithashtu, ai theksoi se, në krahasim me të kaluarën, tashmë kemi më pak raste me lëndime të rënda dhe të lehta. "Më e rëndësishmja është që numri i atyre që kanë humbur jetën këtë vit, gjatë aktivitetit në vendin e punës, është më i vogël, më ç'rast edhe ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta gjithë atyre që kanë humbur më të dashurit e tyre. Me një përkushtim dhe angazhim të përbashkët besoj se do të arrijmë përparim në mënyrë që punëtori të ndihet më i sigurt në vendin e punës dhe punëdhënësi, gjithashtu, në kryerjen e veprimtarisë së vet si biznes", ka thënë ministri Skender Reçica.



## OEK-u dhe OEAK-u priten nga drejtuesit e korporatës DFC në Uashington



PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi dhe drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, janë takuar në Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës me drejtuesit e lartë të Korporatës Financiare Zhvillimore (DFC) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në takim me kryeshëfimin operativ Edward Burrier, këshilltarin e kryeshëfit

ekzekutiv të Korporatës DFC Caleb McCarry dhe me shefin e Stafit, Stewart Ackerly, drejtuesit e dy odave ekonomike biseduan për nevojat e sektorit privat në Kosovë, si dhe sektorët me potencial zhvillimor, të cilët do të mund të përfitonin nga instrumentet mbështetëse të Korporatës DFC.

Zeka dhe Rukiqi theksuan edhe nevojën e angazhimit më të shpejtë të qeverive në Kosovë dhe në Serbi për

zbatimin e zotimeve të marrëveshjes së Uashingtonit si dhe rolin që odat ekonomike nacionale dhe ato amerikane në Kosovë dhe në Serbi mund të luajnë në asistimin e qeverive për zbatimin e pikave të marrëveshjes.

Diskutimi u fokusua edhe në çështjet e lidhura me energjinë dhe nevojën e rritjes së sigurimit të furnizimit në Kosovë si parakusht për zhvillim ekonomik.

## Gjysma e punëve do të kryhet nga makineritë deri në vitin 2025

PRISHTINË, 21 TETOR - Gjysma e detyrave të punës do të kryhet nga makineritë deri në vitin 2025, parashikon një raport i Forumit Ekonomik Botëror. "Revolucioni robot" do të krijojë 97 milionë vende pune në të gjithë botën, por do të shkatërrojë pothuajse po aq, duke i lënë disa komunitete në rrezik", thekson raporti. Sipas tij, punët rutinë ose manuale në administrata dhe në përpunimin e të dhënave janë më të kërcënuar nga automatizimi. Por, thuhet në raport, vende të reja pune do

të hapen për këshillim, komunikim, vendimmarrje dhe ekonomi të gjelbër.

Hulumtimi i Forumit Ekonomik Botëror ka përfshirë 300 nga kompanitë më të mëdha në botë të cilat punësojnë tetë milionë njerëz në të gjithë botën.

Më shumë se 50 për qind e punëdhënësve të anketuar kanë thënë se presin që të shpejtohet automatizimi i disa roleve në kompanitë e tyre, ndërsa 43 për qind kanë thënë se ndiejnë se do të mbyllën vende pune për

shkak të teknologjisë.

Forumi Botëror Ekonomik ka thënë se pandemia e koronavirusit e ka përshpejtuar miratimin e teknologjive të reja, pasi firmat kanë bërë përpjekje t'i zvogëlojnë shpenzimet dhe të gjejnë mënyra të reja të punës.

Forumi Botëror Ekonomik ka njoftuar se aktualisht rreth një e treta e detyrave të punës kryhet nga makineritë, ndërsa pjesa tjetër nga njerëzit, por deri në vitin 2025 "ky ekuilibër do të ndryshojë".



# Çfarë ndodhi me shtesat për fëmijët?

PRISHTINË, 21 TETOR - Kosova është i vetmi vend në rajon i cili nuk aplikon shtesat për fëmijë. Një rezolutë e Kuvendit të Kosovës e vitit 2018, e cila kërkon nga qeveria ta hartojë legjislacionin për ndarjen e këtyre mjeteve financiare për fëmijët, nuk është realizuar deri më tani. Ndarja e shtesave për fëmijë ishte kërkuar të fillojë gjatë vitit 2019. Ndërkaq, shumica mujore duhet të kategorizohet duke marrë parasysh kriteret përkatëse si të hyrat familjare, punësimin e prindërve dhe moshën e fëmijëve.

Në atë kohë deputetët e Kuvendit të Kosovës kishin rekomanduar që shumica mujore e shtesave për fëmijë të jetë prej 10 eurosh dhe t'i përfshijë fëmijët nga mosha 0 deri në 16 vjeç dhe nga kjo ishte llogaritur ta përfitojnë rreth 500 mijë fëmijë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë", thotë se ka vlerësuar se zbatimi i kësaj rezolute do të krijonte një kosto prej rreth 60

milionë eurosh në vit e, si e tillë, është e papërbalueshme për buxhetin e shtetit.

Buxheti i Kosovës i vitit 2019, kur ishte kërkuar të fillonte ndarja e shtesave për fëmijët, kishte vlerën e mbi 2 miliardë euro. Një vlerë të njëjtë buxheti i Kosovës kishte edhe në vitin 2020.

## Shtesa për 80 mijë fëmijë të familjeve me ndihmë sociale

Në pamundësi buxhetore për të shpërndarë shtesa për të gjithë fëmijët në Kosovë, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale thonë se është përzgjedhur opsioni që do ta përfshijë zbatimin e shtesave prej 10 eurosh për fëmijët deri në moshën 18-vjeçare, por vetëm për familjet që janë pjesë e skemës së ndihmës sociale. Një koncept-dokument i tillë tashmë është aprovuar nga qeveria më 14 shtator.

"Me aprovimin e këtij koncept-dokumenti, do të hartohet Ligji i ri i skemës së ndihmës sociale

dhe me hyrjen në fuqi do të fillohet zbatimi i shtesave të fëmijëve, ku planifikohet të përfitojnë rreth 80 mijë fëmijë", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Por, të gjitha këto ndryshime ligjore për të përfituar këto mjete nuk ka ndonjë datë se kur mund të ndodhin. Ministria e Punës nuk jep përgjigje nëse është planifikuar ky shpenzim në buxhetin e vitit 2021.

## Kosova, vendi i vetëm në rajon pa shtesa të fëmijëve

Derisa Kosova ende nuk ka asgjë definitive për shtesat e fëmijëve dhe se për këtë ende pritet të hartohet legjislacion dhe të përcaktohen mënyrat e financimit, vendet e rajonit e kanë të rregulluar këtë çështje. Mali i Zi aplikon shtesa për fëmijët në vlerë prej 23 euro deri në 40 euro, Serbia nga 25 deri në 46 euro, Bosnje e Hercegovina prej rreth 17 euro deri në 40 euro, varësisht nga vendi ku jetojnë. Po

ashtu, edhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut aplikojnë shtesat për fëmijë.

## Shtesat e fëmijëve për të gjithë

Koalicioni i Organizatave Joqeveritare për Mbrojtjen e Fëmijëve, KOMF, që nga viti 2015 ka kërkuar që në skemat sociale të përfshihen edhe shtesat për fëmijë.

Klevis Vajçari nga kjo organizatë thotë për Radion Evropa e Lirë se shtesat për fëmijë, përveç të tjerash, do të ndihmonin edhe në zbutjen e varfërisë. "Sa i përket modelit do të duhet që kjo shtesë për fëmijë të jetë për të gjithë fëmijët, të gjitha kategoritë. Shteti i Kosovës duhet të analizojë pa dëmtuar buxhetin dhe të aprovojë një model. Modeli më i mirë është të ofrohen shtesa për të gjithë fëmijët nga 0 deri 18 vjeç", thotë ajo.

Nismën për shtesat e fëmijëve e pati iniciuar deputetja e Kuvendit të Kosovës nga Aleanca

për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi.

Në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", ajo thotë se ka kërkuar së fundi edhe nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, që të jepen detaje se kur mund të realizohet ndarja e shtesave për fëmijë. "Ndarja e shtesave për fëmijë duhet të ndodhë. Ky do të ishte një hap i duhur sidomos tani në kohë pandemie kur nevojat për përkrahje shtetërore janë rritur, pasi që kriza ekonomike e sociale është thelluar si pasojë e gjendjes në të cilën jemi tash e gjashtë muaj", thotë ajo, duke shtuar se do të vazhdojë të përkushtohet derisa kjo rezolutë për shtesat e fëmijëve të zbatohet në tërësi.

Të gjitha qeveritë e Kosovës nga viti 2018 kishin premtuar se do të realizonin këtë rezolutë dhe do t'i mundësonin shtesat e fëmijëve. Qeveria aktuale me kryeministër Avdullah Hoti në programin qeverisës në pikën e 13, ku flitet për mbrojtjen sociale, ka paraparë edhe shtesat për fëmijë.



## Komisioni për buxhet nuk e miraton Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Komisioni për Buxhet dhe Transfere nuk e ka miratuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike i cili tashmë ka kaluar në lexim të parë, por i duhet edhe një lexim që t'i kalojë procedurat e nevojshme

parlamentare. Komisioni ka vendosur që të mërkurën e ardhshme të shqyrtohen dhe miratohen tetë amendamentet dhe raporti për Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky projektligj mundëson tërheqjen e 10 për qind të

kursimeve në Trust. Ndërsa komisioni ka miratuar raportin vjetor financiar të buxhetit të Kosovës për vitin 2019 si dhe Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.



## Begaj zotohet për avancimin e pozitës së gruas në Malishevë

**MALISHEVË, 21 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, shefja e kabinetit, Blerta Krasniqi dhe zyrtarja për barazi gjinore, Vera Bytyçi, kanë pritur në takim, kryesuesen e Komitetit për Barazi Gjinore, Agnesa Kastratin.

Begaj i ka njoftuar anëtarët e Komitetit për Barazi Gjinore, me përfaqësimin gjinor në institucionet publike të Komunës së Malishevës, si në administratë, shkolla, institucione shëndetësore, kulturore, ku shumë gra udhëheqin dhe menaxhojnë. Me këtë rast, ai ka shprehur gatishmërinë për t'i çuar përpara proceset në sektorin e barazisë gjinore për t'i mbështetur gratë në biznese. "Ky është potenciali për zhvillim dhe mirëqenie socio-

ekonomike të vendit në tërësi, po ashtu deri tash kemi mbështetur kërkesat e tyre si dhe në të ardhmen do t'i mbështesim projektet plotësisht", është shprehur Begaj.

Kurse Agnesa Kastrati është interesuar për punët në Qendrën e Mjekësisë Familjare "Shpëtim Robaj" në Malishevë, pozitën e gruas në jetën institucionale publike e vendimmarrëse. Po ashtu, edhe pjesëmarrëset e tjera në takim ka kanë thënë se janë të interesuara që të ketë më shumë përkushtim për sistemimin dhe avancimin e pozitës së gruas në institucionet publike dhe private, me qëllim që të rritet mirëqenia familjare dhe vendimmarrja e tyre në institucionet vendimmarrëse publike.



## Nis faza e dytë e aplikimit për izolimin termik të shtëpive për familjet në nevojë



**DRENAS, 21 TETOR (ER)** - Komuna e Drenasit ka njoftuar se është hapur faza e dytë e aplikimit për ta përfunduar izolimin termik për familjet në nevojë. "Në fazën e parë nga Komuna e Drenasit kanë qenë përfutuese tetë ekonomi familjare në nevojë, të

përzgjedhura nga stafi kompetent i Fondit të Mijëvjeçarit, si financues kryesor i këtij projekti. Për të aplikuar në këtë projekt në kuadër të SEEK-ut të Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës ju njoftojmë se afati për aplikim është nga data 21.10.2020 deri më

27.10.2020. Projekti SEEK ka hapur mundësi të reja për identifikimin e përfutuesve të mundshëm. Vetë identifikimi nuk përbën aplikim zyrtar për grante të projektit SEEK dhe as nuk garanton ndonjë të drejtë në bazë të projektit", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

## Dhurohen barna për personat me sëmundje kronike në Kamenicë

**KAMENICË, 21 TETOR (ER)** - Shoqata Humanitare "Dora e Djathtë" ka dhuruar sërish donacion për Komunën e Kamenicës. Këtë herë ka dhuruar barna për tre muaj për personat me sëmundje kronike. Nga kjo ndihmë do të përfitojnë rreth 30 familje. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka shprehur mirënjohje për të gjithë ata që po vazhdojnë t'i ndihmojnë qytetarët e

komunës së Kamenicës. "Jam mirënjohës që komuna jonë gëzon këtë shkallë të lartë të mirësisë. Këto donacione janë të mirëpritura gjithmonë, sepse po ndihmojnë jashtëzakonisht mirëqenien e qytetarëve tanë", ka thënë Kastrati.

Edhe drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zaimi-Krasniqi, ka falënderuar shoqatën për donacionin. "Falënderojmë

organizatën për donacionin dhe të gjithë donacionet e tjera që janë bërë në Kamenicë, sepse në këtë mënyrë po u ndihmojmë sadopak atyre që kanë nevojë. Sfidat e pandemisë i kalojmë më lehtë kur jemi bashkë", ka deklaruar Zaimi-Krasniqi.

Kjo shoqatë ka njoftuar se do t'i vazhdojë projektet humanitare për shpërndarjen e gjërave ushqimore.

## 51 fermerë të Suharekës përfitojnë fidanë të arrës

**SUHAREKË, 21 TETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se kanë bërë shpërndarjen e mbi 4 000 fidanëve të arrës për 51 fermerë të kësaj komune. Me këtë rast Muharremaj ka thënë se përkrahja për sektorin e bujqë-

sisë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "4 100 fidanë të arrës u janë dhënë 51 fermerëve subvencione nga Drejtoria e Bujqësisë. Përkrahja për sektorin e bujqësisë do të vazhdojë edhe më tutje që t'i stimulojmë për rezultate sa më të mira", është shprehur Muharremaj.



# Eksperimentet e Shpendit me kryeqytetin janë të papranueshme

Shkruan: Ferat SHALA, deputet i Kuvendit të Kosovës



Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, po vazhdon që të eksperimentojë me kryeqytetin, në përpjekje që ta mbulojë mungesën e rezultateve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Së fundi ai e bëri publik një propozim sa absurd aq edhe diskriminues, qesharak dhe i pamenduar mirë.

Propozimi që në zonën e qendrës së kryeqytetit të aplikohet taksa prej 10-eurosh për parkim të veturave, në funksion të përmirësimit të cilësisë së ajrit, përveç që është një taksë e papërbalueshme për buxhetin e qytetarëve, nuk është një masë që do të sillte rezultate për qëllimin për të cilin po zbatohet.

Nga përvoja ime si ministër dhe zëvendësministër në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga përvoja si ligjërues i lëndës së transportit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, si dhe bazuar nga shembujt dhe praktikatat që zbatohen në vende të ndryshme që kanë probleme me ndotjen e ajrit, vlerësoi se ka mundësi të aplikimit të shumë masave tjera më efikase dhe më të pranueshme për reduktimin e ndotjes së ajrit nga transporti. Përmes këtij reagimi i rikujtoi z. Shpend Ahmeti, vetëm disa prej masave dhe veprimeve të tjera që duhet të ndërmerren nga Komuna e Prishtinës për reduktimin e ndotjes së ajrit në kryeqytet para zbatimit të

taksave për parkim të automjeteve në zonën e qendrës.

1. Komuna e Prishtinës, duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit sikurse e kërkon Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, ku do të duhej të përfshihen edhe masat për reduktimin e ndotjes nga trafiku; 2. Komuna e Prishtinës, do të duhej që tanimë të kishte një Plan të Mobilitetit të bazuar në hulumtime dhe masa konkrete që do të rrisnin efikasitetin e transportit urban dhe do të reduktonin ndotjen e ajrit nga ky sektor; 3. Komuna e Prishtinës, është dashur që të mendojë që edhe me rastin e blerjes së autobusëve për trafikun urban, që ata të ishin

më miqësorë me mjedisin dhe jo autobusë dizel dhe me nivel të lartë të shkarkimeve në ajër; 4. Komuna e Prishtinës, do të duhej të caktonte ndalesa dhe zona të qarkullimit të mjeteve motorike në kryeqytet sipas kategorive të automjeteve; 5. Komuna e Prishtinës, do të duhej të zbatonte subvencione për promovimin e transportit, shtimin e linjave dhe rritjen e efikasitetit të tij; 6. Komuna e Prishtinës, do të duhej të angazhohej maksimalisht në ndalimin e veprimtarisë së operatorëve ilegal të taksive që ndikojnë dukshëm në shtimin e ndotjes nga transporti; 7. Komuna e Prishtinës, do të duhej që të zbatonte orare të rregullta të pastrimit të rrugëve me qëllim të reduktimit të

ndotjes nga pluhuri i rrugëve; 8. Komuna e Prishtinës në funksion të reduktimit të ndotjes së ajrit nga transporti do të mund të caktonte orare specifike për furnizime, auto-shkolla dhe veprimtari të tjera që janë të bazuara në shfrytëzimin e transportit. Këto janë vetëm disa prej veprimeve që mund të zbatohen nga Komuna e Prishtinës për reduktimin e ndotjes së ajrit nga transporti, në kuadër të shumë masave tjera që kryeqyteti ynë të bëhej shembull dhe model edhe për qytetet e tjera. Por, në vend të një qyteti model dhe në vend të shembujve e praktikave të mira, ne duhet të presim propozime absurde nga kryetari i kryeqytetit.

## Nënshkruhet memorandumi me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, Ervin Mete, kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit në funksion të rregullimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve. Përmes këtij memorandumi BQK-ja dhe AMF-ja vendosin një sistem bashkëpunimi reciprok dhe shkëmbim të informacioneve mes palëve, bazuar në rëndësinë e zhvillimit të tregjeve financiare të të dyja vendeve, i cili do të shtrihet në tregjet e sigurimeve/risigurimeve, tregjet e kapitalit, aktivitetet të tjera financiare jobankare. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka vlerësuar të rëndësishëm nënshkrimin e këtij memorandumi. Ai u ndal te rëndësia e bashkëpunimit reciprok mes dy rregullatorëve në adresimin e çështjeve me interes të përbashkët, në funksion të mbarëvajtjes dhe zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje. Ndërsa drejtori i AMF-së, Ervin

Mete, ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për angazhimin e tij në finalizimin e këtij memorandumi, duke theksuar se marrëveshja e re e bashkëpunimit iu përgjigjet jo vetëm zhvillimeve të kohës, por edhe çështjeve që kanë dalë në pah ndër vite mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, parashihet vlefshmëria reciproke e policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikatat e dëmeve. Memorandumi thëllon linjat e bashkëpunimit mes dy rregullatorëve në funksion të mbikëqyrjes së integruar dhe efektive, në veçanti përmes kolegeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit, për shoqëritë vendase të sigurimit dhe risigurimit, të cilat kanë investime apo degë të tyre në vende të tjera.

Gjithashtu, sa i përket tregut të sigurimeve, palët angazhohen të adresojnë çështje të veçanta të mbikëqyrjes në të dyja vendet, si vlefshmërinë reciproke të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj



palëve të treta, detyrimet reciproke mbi praktikatat e dëmeve apo trajtimin dhe pagesën e dëmeve. Në lidhje me tregjet e kapitalit, Shqipëria është në një stad më të avancuar për sa i përket kuadrit ligjor, nëpërmjet ligjeve të miratuara së fundmi, si dhe ka krijuar infrastrukturën e tregut, bursën dhe regjistrarin. Autoriteti është i gatshëm ta

asistojë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në këtë drejtim. Gjithashtu, dy rregullatorët do të bashkëpunojnë në funksion të përmirësimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit, duke iu përgjigjur evoluimit të vazhdueshëm të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe shkëmbimin e përvojave nëpërmjet

takimeve të ndërsjella në funksion të rritjes së mëtejshme të standardeve në fushën e digjitalizimit dhe sigurisë kibernetike. Memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar nga të dyja palët do të jetë në fuqi për një periudhë kohore të pakufizuar, kurse i njëjti shfuqizon memorandumin e mëparshëm që ishte në fuqi nga viti 2008.



Remzi Hoxha




# 25 vite nga zhdukja/ Flet i biri i Remzi Hoxhës: I kemi të gjithë faktet, nëse do SPAK, përgjegjës është Sali Berisha!

25 vite nga zhdukja e Remzi Hoxhës, nga ajo ditë e kobshme e 21 tetorit 1995, familjarët e tij kanë vendosur të ndërtojnë varrin dhe memorialin e të dashurit të tyre pa eshtrat e tij. Të cilët shteti shqiptar nuk ja ka dhen mundësinë që t'i kenë. Edhe pse mundësia edhe filli për t'i gjetur janë aty. Janë bërë kaq shumë dokumentarë, shkrime, hetime, seanca gjyqësore deri edhe ndërkombëtare, por që ka qenë pikërisht kupola e shtetit shqiptar që ka ndihmuar të vërtetën.

I biri i Remzi Hoxhës, Ardiani, në një intervistë për "Shqip", i përmend me emër të gjithë politikanët që nuk kanë bërë atë që duhet për të zbardhur të vërtetë, megjithëse kanë pasur mundësi. Por ardiani nuk ka dilemë për përgjegjës: "është Sali Berisha", thotë dhe bë të ditur se zotëron të gjitha faktet që mund të sjellin të vërtetën nëse hapet hetimi nga SPAK. Por ai natyrisht nuk ka shpresë dhe ndoshta ka arsye për një mallkim që i vjen nga shpirti: "Haram u qoftë gjaku i babait tim", kjo është një turp për Shqipërinë pasi Remzi Hoxha luftoi pikërisht për vlerat e lirisë dhe flamurin...

I nderuar Ardi, ti tashmë je një emër i njohur i shoqërisë dhe i sipërmarrjes së Kosovës, një personazh që je bërë i njohur për novacionet e teknologjisë dhe shërbimet, arsimin etj, por ne në Shqipëri të njohim si djalin e Remzi Hoxhës, edhe për faktin se prej shumë vitesh e ke mbajtur ti



betejën me "Murin që S'bzant" për një të drejtë të që gjithkujt i takon, që shumë shqiptarë prej 1999 e kërkojnë në Serbi e ti e kërkon në shtetin tënd në Shqipëri: një varr për babain tënd, të ndjerin Remzi Hoxhën. Më lejohet të pyes, a ju janë tharë lotët? Është e vërtetë Ylli dhe sot bëhen 25 vjet që familja jonë përpiqet t'i

gjejë eshtrat e babait tim. Dhembja është shumë e madhe dhe ketë dhembje e kuptojnë më së miri ata që kanë familjarë të zhdukur. Është shumë e dhimbshme kur na vdes ndonjë familjar, e sidomos në moshë të re, këtë mendoj se e kanë përjetuar shumë familje dhe mund ta kuptojnë, por kur ke një familjar të zhdukur, në moshë të

re, dhe nuk e din as varrin ku e ka është shumëfish më e vështirë dhe nuk mund ta përshkruash. Plagën do e kemi gjithmonë për humbjen tonë, por shpirti do na flet më rehat kur t'ia bëjmë varrin babait tim dhe kur t'i vijnë eshtrat. Ne kemi humbur një baba, burrë, vëlla dhe djalë, pra kemi humbur një familjarin tanë, por humbje edhe me e madhe është për kombin tonë, sepse historia do e tregojë veprimtarinë e tij e cila iu ndal në gjysmë. E ka pritur të keqen edhe ai nga shteti serb, por që e keqja do i vijë nga Shqipëria mëmë, asnjëherë. Kjo është që gjithë familjes dhe bashkëveprimtarëve të babait tim na dhemb më së shumti. Ky është një turp që do e mbajë Shqipëria dhe gjithë klasa politike e institucionet e drejtësisë.

Serbia dihet botërisht që po fsheh eshtrat e personave të vrarë në luftën e Kosovës, por edhe Shqipëri po bën të njëjtën dhe kjo është shumë e dhimbshme dhe njëkohësisht për të ardhur keq.

Ju si familje do të flisni edhe në konferencën e shtypit për 25 vjetorin e masakrës më të rëndë që një shtet ka kryer prej vitit 1990 ndaj një shqiptari, por unë do doja të pyesja hapur. Keni kërkuar të dënohen fajtorët për dhunimin e babait tuaj, me kalimin e viteve kërkon vetëm eshtrat. Mendoni se beteja për drejtësi i ka humbur çdo shpresë? Sot bëhen një çerek shekulli që ne po kërkojmë drejtësi në Shqipëri. Na u deshën 17 vite që

gjykata në Shqipëri të dënojë personat përgjegjës, por dhe duke amnistuar disa nga ta e njërin edhe duke e strehuar jashtë shtetit. Edhe 8 vite tjera kaluan dhe shihet se nuk ka vullnet politik ose institucional që të na i gjejnë eshtrat. Jemi të zhgënjyer nga gjithë klasa politike, pa dallim, dhe nga gjitha institucionet e drejtësisë në Shqipëri, përfshirë edhe SPAK-un. Për t'ua hapur rrugën individëve që dinë se ku janë fshehur eshtrat e babait tim, për t'u treguar që nuk janë të rrezikuar nga ne, e kemi deklaruar publikisht që nuk kërkojmë as dënimin e tyre e as të marrim hak për gjakun e tij. Kërkojmë vetëm eshtrat e tij që t'ia bëjmë një varr. Nuk kemi më shpresë nga Shqipëria.

Para pak kohësh, Sali Berisha, foli në RTK edhe për këtë rast. Ka folur edhe për Berat Buzhalën më parë, për Rrokumin, për Dukagjinin, dhe ka pasur thujtë gjithmonë nga një version pak më ndryshe. E di se ju prek në plagë, por ç'mund të thoni për këtë ndryshim të shpeshtë të versioneve?

Sali Berisha si politikan që është mundohet edhe rastin e babit tim ta kthejë në një kontekst politik dhe thotë që familja jonë përpiqet që ta dëmtojë atë politikisht dhe ta ndihmojmë Partinë Socialiste. E theksoj prapë se ne nuk na intereson as politika e Shqipërisë, as Partia Socialiste, as Partia Demokratike, as LSI, as asgjë.

Ne na ka interesuar dhe na intereson të gjejmë eshtrat e babait tim dhe kaq! Është e vërtetë që politikanë nga Partia Socialiste e kanë përdorur rastin e baba tim, si Erion Braçe, Gramoz Ruçi, Saimir Tahiri, e shumë tjerë, për të hedhur gurë mbi Sali Berishën dhe Partinë Demokratike, por ketë do e kishin bërë edhe Partia Demokratike po të kishin qenë dikush nga Partia Socialiste që kishte vranë babanë tim.

Për familjen tonë të gjithë janë të njëjtë dhe nuk na intereson politika në Shqipëri. U bëmshin copë të gjithë. Përgjegjës për zhdukjen e babait tim është Sali Berisha, sepse njerëzit e tij e vranë. Edhe Millosheviçi nuk erdhi në Kosovë vet që t'i vriste njerëzit, ishin ushtria dhe shërbimet e tija që e bënë, por urdhrat i jepte ai.

Është e njëjta situatë. Përgjegjës pastaj janë edhe Fatos Nano, edhe Ilir Meta, edhe Edi Rama, por edhe gjitha institucionet e drejtësisë, duke përfshirë edhe SPAK-un. Ky është një turp për Shqipërinë dhe haram u qoftë gjaku i babait tim!

**Në Shqipëri ka një njeri që sot pritet të gjykohe për një ngjarje tjetër të rëndë, vrasjen e deputetit Azem Hajdari, është ish-truproja e Sali Berishës, Izet Haxhia. Ai ka dhënë disa intervista ku mka folur edhe për rastin e zhdukjes së Remzi Hoxhës. A e keni ndjekur dhe a mendoni se përbën një element të ri për hetimet?**

Unë nuk kam pasur rastin të takohem me Izet Haxhinë, por i kam përcjell disa nga intervistat e tija dhe ai dëshmon për ngjarje që lidhen me rastin e babait tim. Edhe ky është një dështim i institucioneve të drejtësisë, duke përfshirë edhe SPAK-un, që nuk hapin hetime bazuar në dëshmitë e tij. Njerëzit e implikuar në këtë rast jetojnë të



Remzi Hoxha me Bashkëshorten

Jemi të zhgënjyer nga gjithë klasa politike, pa dallim, dhe nga gjitha institucionet e drejtësisë në Shqipëri, përfshirë edhe SPAK-un. Për t'u hapur rrugën individëve që dinë se ku janë fshehur eshtrat e babait tim, për t'u treguar që nuk janë të rrezikuar nga ne, e kemi deklaruar publikisht që nuk kërkojmë as dënimin e tyre e as të marrim hak për gjakun e tij. Kërkojmë vetëm eshtrat e tij që t'ia bëjmë një varr. Nuk kemi më shpresë nga Shqipëria/ Ardian Hoxha

lirë në Shqipëri dhe janë rrezik edhe për shumë qytetarë të Shqipërisë.

**Në Shqipëri, drejtësia e vjetër po rrëzohet dhe sot kemi institucione të reja siç është SPAK, pra Prokuroria Speciale që heton zyrtarët e Lartë, BKH, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Gjykata e Posaçme kundër krimit të Organizuar dhe Korrupsionit që veprojnë në kuadër të reformës në Drejtësi. Ju keni bërë betejë shumë të gjatë dhe jeni dërrmuar me drejtësinë shqiptare. A do ta provoni edhe me institucionet e reja që të paraqisni fashikujt e dosjeve e fakteve që ju posedoni?**

Duke qenë se ne kemi qenë palë e dëmtuar, në proceset gjyqësore na ka përfaqësuar prokuroria e shtetit. Rasti i babait tim është ndër rastet më të rënda të Shqipërisë dhe edhe SPAK-u e këto institucionet tjera nuk kanë bërë asnjë hap për të zbardhur rastin tonë. Mendoj se drejtësia në Shqipëri është e kontrolluar nga politika, "e kapur" siç themi ne, dhe përveç mungesës së vullnetit, njerëzit e punësuar aty kanë frikë të merren me rastin e babait tim.

Ne kemi adresë dhe mund të na kontaktojnë kur të duan, por nuk kam më shpresë se dikush do bëjë diçka në këtë aspekt. Ky turp do i mbetet Shqipërisë dhe do mbetet një borxh që Shqipëria do ja ketë Kosovës.

**Ardi, një pyetje. Keni dijeni për emrat që para disa vitesh u hetuan, u burgosën por që më pas u liruan një nga një që nga Ilir Kumbaro në Angli. Keni ju të dhëna se ekziston ndonjë dëshmitar që mund të ndihmojë në hapjen e procesit?**

Po, patjetër. Është Avni Koldashi që ishte njëri nga 9 personat që morën babain tim fizikisht nga vendi i punës dhe ai e dëshmon ngjarjen ashtu siç ka qenë dhe siç na e kanë treguar punonjësit e baba tim që ishin dëshmitarë ditën e rrëmbimit. Ai po ashtu tregon se si dhe ku ia ka dorëzuar babain tim Arben Sefgjinit.

Të njëjtën dëshmi e ka dhënë edhe në gjykatë edhe në një intervistë për Top Channel. Edhe ky nuk do dëshmonte, por ky e bëri që të shpëtonte kokën e tij dhe të mos e vrisnin edhe atë për të eliminuar provat. Është edhe Arben Sefgjini që jeton i lirë në Shqipëri. Po ashtu i implikuar tjetër është Budjon Meçe, por që ka vdekur në vitin 2018 dhe për implikimin e tij e njoftova edhe Edi Ramën edhe Saimir Tahirin

në vitin 2016, por asnjëri nuk pati vullnet, përkundër premtimeve, që të vinin në lëvizje policinë dhe prokurorinë.

Pastaj është edhe Ilir Kumbaro i cili është në arrati dhe sa ishte para gjyqit në Londër mbrohej nga avokatët e Sali Berishës, që është edhe një tregues tjetër i implikimit të tyre si grup. Zinxhirin e këputën me kaq dhe nuk u fut Bashkim Gazidede në këto hetime e as Sali Berisha. Të gjitha këto janë në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda të Shqipërisë, AKTI NR. 2/3/8/26/79, VENDIMI NR.77, Datë 22.11.2012, si dhe vendimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, NR. 3/83 i regjistrimit themeltar, Nr. 19 i vendimit, Datë 10.12.2012 regjistrimi, Datë 18.03.2013.

Ka pasur gjithë këto vite një



interes nga njerëzit për të njohur sa më shumë të vërtetën, por nga shteti shqiptar e strukturat e tij ju keni marrë vetëm përgjigje negative. A mund ta bësh sot pas 25 viteve një analizë apo një mendim që kush janë ata njerëz në Shqipëri që ju kanë ndihmuar më shumë?

Njerëzit që na kanë ndihmuar më shumë janë Xhevat Hana i ndjerë, që në fakt thoshte se unë vetëm po bëj punën time. Ishte Avokati i Popullit Ermir Dobjani. Janë edhe shumë emra që nuk mund t'i përmend me kërkesë të tyre, sepse mund t'u rrezikohet jeta e tyre apo familjeve të tyre. Më ka ndihmuar edhe Mentor Nazarko, por edhe shume e shume gazetarë të tjerë, që ndoshta edhe mund t'i harroj disa dhe për këtë u kërkoj ndjesë paraprakisht.

Janë Artan Hoxha, Muhamet Veliu, Anila Hoxha, Rudina Xhunga, Alban Dudushi, Dorjana Daka, Andi Malasi, Artur Qorraj, Entela Resuli, Erena

Haska, Klodiana Lala, Leonard Bakllari, Mero Baze, dhe në fund por jo më pak i rëndësishëm, ju Ylli Pata. Janë këta gazetarë që kanë mbajtur presionin publik dhe shtëpitë e tyre mediale që kanë bërë që sado pak të vazhdojë procesi gjyqësor dhe të vërtetohet se kush ishin njerëzit e implikuar në këtë krim. U jemi mirënjohës gjatë gjithë jetës, faleminderit të gjithëve.

**E keni nisur këtë betejë kur ishit fëmijë, e sot pas 25 vjetësh jeni një burrë, jetoni në Kosovën që Remzi Hoxha dha jetën për ta çliruar, në linjën e parë të luftëtarëve të rezistencës. Keni sakrifikuar kaq shumë përveç babait tuaj të ndjerë, edhe familjarët tuaj. A ja ka vlejtur dhe cili është mesazhi juaj për gjeneratat e reja që pak kanë dëgjuar për këtë rast kaq makabër e brutal...**

Unë, vëllezërit dhe motrat e mija, xhaxhallarët, kushërinjtë, dhe bashkëveprimtarët e babait tim nuk jemi ndalur dhe kemi sakrifikuar shumë gjatë gjithë këtyre viteve së pari sepse do e bënim për atë si qenie njerëzore, por edhe më shumë për shkak se kush ishte dhe çfarë kishte bërë ai gjatë jetës së tij. E thash edhe më herët, është shumë humbje e madhe për familjen tonë, por humbje edhe më e madhe për popullin tonë, në Shqipëri e Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, Kosovë Lindore, Greqi e Turqi. Duke u marrë me gjetjen e eshtrave të tija, nuk jemi marr asnjëherë me zbardhjen e

veprimtarisë së tij, por shumë shpejt do i shpalosim veprat e tij në një dokumentar të bazuar në dokumentacione dhe do e kuptojmë se çfarë ka humbur kombi ynë. Unë e di që edhe baba im do bënte edhe më shumë po t'i kishte ndodhur e njëjta dikujt tjetër. Atij nuk i është dhembur jeta e tij, e edhe neve nuk na dhembet jeta për te. Kemi shumë thënie popullore që tregojnë se e vërteta herët a vonë do dali në shesh.

Thuhet që "edhe therrat (thumbat) do tregojnë se ku janë eshtrat", ose "e vërteta vonon, por nuk harron", e shumë e shumë të tjera. Andaj, mesazhi për gjeneratat e reja është ia vlen të sakrifikosh jetën për të zbardhur të vërtetën e ndonjë familjari. Po ashtu, të mos ndalemi së punuari e t'i bëjmë krenar gjithë familjen e edhe ata që nuk janë më në mesin tonë. Zoti do i dënojë ata që kryejnë krime, qoftë në këtë botë qoftë në botën tjetër.



Ardian Hoxha

## Maqedonia e Veriut, masa të reja kundër Covid-19

SHKUP, 21 TETOR - Në Maqedoninë e Veriut të mërkurën kanë hyrë në fuqi masat e reja kufizuese për mbrojtje nga Covid-19, e që kryesisht kanë të bëjnë me transportin publik, punën e objekteve të gastronomisë dhe administratën publike. Vendimi i qeverisë parasheh që të gjitha lokalet dhe restorantet të punojnë deri në orën 23:00, transporti publik ta reduktojë në 50 për qind kapacitetin e pasagjerëve, ndërsa institucionet shtetërore dhe publike ta organizojnë punën e të punësuarve me turne, rotacion apo edhe punë nga shtëpia. Qeveria ka lënë në fuqi edhe

masën për mbajtjen e aktiviteteve sportive pa praninë e shikuesve. Ndërkohë, nuk ka ende marrëveshje mes partive për masat e tjera që kanë të bëjnë me mbajtjen e maskës në ambiente të hapura, ndalimin e grumbullimit të më shumë se katër personave pas orës 22:00, si dhe ndalimin e vizitave të më shumë personave nëpër familje.

Këto masa nuk mund të miratohen pa mbështetjen e opozitës, meqë shumica parlamentare nuk i ka votat e mjaftueshme.

VMRO DPMNE-ja opozitare ka thënë se qëndrimin e saj do ta kumtojë pas shqyrtimit të

masave dhe nevojës për miratimin e tyre. Ajo, ndërkohë, ka kërkuar shkarkimin e Komisionit për Sëmundje Infektive dhe zëvendësimin e tij me një komision prej 11 anëtarësh, të përbërë nga ministri i Shëndetësisë, drejtori i Qendrës për Menaxhim me Kriza, infektologë, epidemiologë, imunologë dhe specialistë të sëmundjeve të brendshme.

Maqedonia e Veriut, të martën, ka regjistruar 406 raste të reja me koronavirus, katër viktima dhe 280 të shëruar. Numri i rasteve të reja atje është në rritje sikurse në pjesën më të madhe të Evropës.



## Google përballet me padi nga Shtetet e Bashkuara



NYU JORK, 21 TETOR- Gjiganti i kërkimeve në internet, Google, përballet me padinë më të madhe të mosbesimit, të paraqitur nga Shtetet e Bashkuara, në më shumë se dy dekada. Departamenti i Drejtësisë, së bashku me 11 shtete amerikane, paraqitën padinë të martën, duke pretenduar se Google "është portë e pasfiduar për në internet për miliarda përdorues" dhe se abuzon me pozicionin dominues për të shkatërruar konkur-

rencën. "Ka ardhur koha për ta ndaluar sjelljen anti-konkurrese të Google", thuhet në padi.

Kompania simotër e Google, Alphabet, aktualisht ka vlerën në treg mbi një trilion dollarë. Në vitin 2019, vetë Google ka pasur të ardhura prej 162 miliardë dollarësh.

Google e mbrojti veten pas paraqitjes së padisë, duke thënë se "njerëzit e përdorin atë sepse zgjedhin ta bëjnë një gjë të tillë, e jo sepse detyro-

hen ose nuk kanë alternativa". Ky është rasti më i madh i mosbesimit në Shtetet e Bashkuara prejse gjykata, në vitin 1999, ka vendosur se kompania Microsoft ka krijuar monopol në tregun e sistemeve operative kompjuterike. Vëzhguesit thonë se padia kundër Google mund të shënojë fillimin e një numri padish kundër kompanive të tjera të mëdha të teknologjisë, si: Apple, Amazon dhe Facebook.

## Senati amerikan voton për gjyqtaren e Gjykatës Supreme më 26 tetor

WASHINGTON, 21 TETOR - Senati i Shteteve të Bashkuara do të votojë më 26 tetor për të nominuarën për gjyqtare të Gjykatës Supreme, Amy Coney Barrett.

Lajmi u bë me dije nga udhëheqësi i shumicës në Senat, Mitch McConnell.

Votimi i bie të mbahet vetëm

një javë përpara zgjedhjeve presidenciale në ShBA.

Barrett është nominuar nga presidenti Donald Trump, pas vdekjes së gjyqtarës liberale, Ruth Bader Ginsburg, muajin e kaluar.

Senati, i cili kontrollohet nga Partia Republikane e Trumpit, pritet të votojë në favor të

gjyqtarës konservatore. Votimi pro do ta zgjeronte shumicën konservatore në gjykatë, në proporcion gjashtë me tre. Gjykata Supreme në ShBA vendos për disa nga çështjet më të rëndësishme politike dhe kulturore, përfshirë abortin, kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e votimit.



## Çekia kthehet në izolim për shkak të shifrave rekorde me Covid-19

PRAGË, 21 TETOR - Qeveria e Republikës Çeke ka miratuar një sërë masash që e izolojnë vendin, i cili po përballet me shifra rekorde të rasteve me Covid-19.

Kryeministri Andrej Babis ka thënë në një konferencë për media të mërkurën se masat, që do t'i mbyllin të gjitha dyqanet jo të domosdoshme dhe do ta kufizojnë lëvizjen e njerëzve vetëm

për qëllime të domosdoshme, si puna, familja apo blerja e ushqimeve, do të zgjasin së paku deri më 3 nëntor. "Para së gjithash, ne duhet t'i mbrojmë jetët e qytetarëve", ka deklaruar Babis, për të shtuar se masat do të hyjnë në fuqi nga data 22 tetor.

Vendimi vjen pasi Çekia njoftoi të mërkurën se në 24 orët e kaluara ka regjistruar 11 984 raste të



reja me Covid-19, shifër kjo rekorde. Ministri i Shëndetësisë, Roman

Prymula, ka pohuar se parashikimet tregojnë se numri i rasteve të reja ka të ngjarë të arrijë kulmin rreth datës 11 nëntor. Të mërkurën zëvendëskryeministri çek Jan Hamacek, i cili është, po ashtu, ministër i Brendshëm dhe udhëheqës i shtabit të krizave, që koordinon përpjekjet logjistike për ta luftuar pandeminë, njoftoi se ka dalë pozitiv në testin për Covid-19.


Republika Çeke, vend me 10.7 milionë banorë, ka konfirmuar në total mbi 190 000 raste me Covid-19, mbi 120 000 prej tyre vetëm gjatë tri javëve të para të tetorit.

Shifrat e Ministrisë së Shëndetësisë, të publikuara të mërkurën, tregojnë se numri i viktimave nga Covid në Çeki është rritur për 106, përkatësisht në 1 619, në 24 orët e kaluara.

# Një vend i pastër, i ndriçuar mirë tregim nga Ernest Hemingway

“ [Hemingway] ka mpakur velin ndarës mes letërsisë dhe jetës; gjë për të cilën çdo shkrimtar orvatet. A e keni lexuar ‘Një vend i pastër, i ndriçuar mirë’?... Është mjeshtëror. Ç’është e vërteta, bëhet fjalë për një ndër tregimet më të mirë që janë shkruar ndonjëherë.

James Joyce ”



Ishte vonë dhe në kafene nuk kish mbetur njeri përveç një plaku të ulur nën hijen e gjetheve të pemës që mbulonin ndriçimin elektrik. Gjatë ditës, rruga ishte e pluhurosur, por natën vesa e sheshonte pluhurin dhe plakut i pëlqente të ulej vonë pasi duke qenë shurdh, e ndjente dallimin tani që natën ish qetë. Dy kamerierët brenda kafenesë e dinin se plaku ishte pak i pirë; e pavarësisht se ai i përkiste sojit të klientëve të mbarë, ata dinin gjithashtu se po të pihej tepër plaku do të largohet pa paguar. E për këtë arsye nuk ia hiqnin sytë.

“Javën e kaluar desh të vriste veten,” tha njëri kamerier.

“Pse?”

“Ish bërë helm.”

“Për ç’arsye?”

“Për hiçgjë.”

“Nga e di ti se për hiçgjë?”

“Se e ka kuletën plot.”

Ata qenë të ulur bashkë në një tavolinë mbështetur ndanë murit ngjitur me derën e kafenesë dhe vështronin nga tarraca, atje ku tavolinat ishin të gjitha bosh përveç asaj ku ishte ulur plaku nën hijen e gjetheve të pemës që era zhvendosi lehtas. Një vajzë dhe një ushtar kaluan në rrugë. Ndriçimi i rrugës bëri që të shkëlqejë numri i tunxhtës mbi jakën e tij. Vajza nuk mbante shami në kokë dhe nxitonte krah tij.

“Kanë për ta gjetur rojet,” tha njëri kamerier.

“E ç’rëndësi ka nëse ia arrin qëllimit që i ka vënë vetes?”

“Bën mirë të mos dalë rrugëve. Rojet do ta zënë. Kaluan këtu vetëm pesë minuta më parë.”

Plaku i ulur në hije i ra pjetëzës me gotë. Kamerieri më i ri në moshë i vajti pranë.

“Çfarë do?”

Plaku i drejtoi shikimin. “Edhe një konjak,” i tha.

“Do pihesh,” i tha kamerieri. Plaku i drejtoi shikimin. Kamerieri u largua.

“Ka për të ndenjtur gjithë natën,” i tha shokut të vet të punës. “Po më zë gjumi tani. Kurrë nuk arrij të futem në shtrat para orës tre. Më mirë ta kish vrarë veten që

javën e kaluar.”

Kamerieri mori shishen e konjakut dhe një tjetër pjetëz prej banakut brenda kafenesë dhe u drejtua jashtë për te tavolina e plakut. Uli pjetëzën dhe mbushi gotën me konjak.

“Më mirë ta kish vrarë veten që javën e kaluar,” i tha plaku të shurdhër. Ky lëvizje gishtin e tij.

“Edhe një çikë,” tha. Kamerieri hodhi aq sa konjaku doli nga buzët e gotës dhe rrëshqiti mbi pjetëzën në majë të grumbullit. “Faleminderit,” tha plaku. Kamerieri ktheu shishen brenda kafenesë. Pastaj u ul sërish në tavolinë me shokun e tij të punës.

“Tani është pirë,” tha.

“I pirë është përnatë.”

“Pse desh të vriste veten?”

“Nga ta di unë?”

“Po në ç’mënyrë?”

“Vari veten me litar.”

“Po kush e shpëtoi?”

“Mbesa.”

“Po ç’e shtyu?”

“Meraku për shpirtin e tij.”

“Sa para ka ai?”

“Sa të duash.”

“Duhet t’i ketë nja tetëdhjetë vjet.”

“Sidoqoftë, po themi se ishte tetëdhjetë vjeç.”

“Do desha shumë që të ikte në shtëpi. Kurrë nuk arrij të hyj në shtrat para orës tre. Orë për t’u futur në shtrat është ajo?”

“Ai rri zgjuar pasi i pëlqen kjo gjë.”

“Ai është fillikat. Unë jo. Kam grua që më pret në shtrat.”

“Edhe ai kishte një grua dikur.”

“Një grua nuk do i bënte më punë tani.”

“Që ç’ke me të. Një grua do i bënte punë.”

“Kujdeset mbesa për të. Ti the se që ajo që e shpëtoi.”

“E di.”

“Nuk do desha kurrë të isha aq plak. Një plak të ngjall ndot.”

“Jo gjithmonë. Ky është plak i pastër. Pi pa u ndotur. Madje dhe tani që është i pirë. Shihe.”

“As ma ndjen ta shoh. Dua vetëm që të shkojë në shtëpi të vet. Ai as që e vret mendjen për ata që kanë punë.”

Plaku hoqi sytë nga gota dhe

hodhi një vështrim përgjatë sheshit, pastaj pa nga kamerierët.

“Një tjetër konjak,” tha, me gishtin drejtuar gotës. Kamerieri që e kishte me ngut i vajti pranë.

“Mbaroi,” ia ktheu, duke ngrënë fjalët siç përpiqen debilët kur duan të shpjegohen para të dehurve apo të huajve. “Kaq sonte. Mbyllur tani.”

“Edhe një,” tha plaku.

“Jo. Mbaroi.” Kamerieri fshiu anët e tavolinës me një pecetë dhe tundi kokën në shenjë mohimi.

Plaku u ngrit në këmbë, numëroi pjetëzat me ngadalë, nxori një kuletë lëkure nga xhepi dhe pagoi për pijet, duke lënë gjysmë *peseta* bakshish. Kamerieri e pa tek dilte në rrugë, atë burrë plak që ecte duke u lëkundur, por me dinjitet.

“Pse s’e le të qëndronte dhe të pinte?” pyeti kamerieri që s’e kishte me ngut. Ata po mbyllnin qepenat. “Nuk ka vajtur dy e gjysmë.”

“Dua të kthehem në shtëpi dhe të futem në shtrat.”

“Ç’vlerë ka një orë më shumë?”

“Për mua ka më vlerë se për atë.”

“Një orë nuk bën ndryshim.”

“Flet si të ishe vetë plak. Ai mund të blejë një shishe dhe ta pijë në shtëpi.”

“Nuk është e njëjta gjë.”

“Jo, nuk është,” pranoi kamerieri me grua. Nuk donte të tregohej i padrejtë. Veçse e kishte me ngut.

“Po ti? Nuk ke frikë të kthehesh në shtëpi përpara orarit të zakonshëm?”

“Mos do të më fyesh?”

“Jo, *hombre*, thjesht po bëja shaka.”

“Jo,” tha kamerieri që e kishte me ngut, teksa çohet pasi kishte ulur qepenat. “Kam besim tek vetja. Jam plot me besim te

vetja.”

“Ke rininë, ke besimin te vetja, ke dhe një zanat,” tha kamerieri më në moshë. “I ke të gjitha.”

“Po ty çfarë të mungon?”

“Të gjitha veç zanatit.”

“I ke të gjitha njësoj si unë.”

“Jo. Nuk kam pasur kurrë besim te vetja dhe nuk jam i ri.”

“Ec tani. Mjaft fole së koti dhe vëri drynin.”

“I përkas atyre që u pëlqen të rrinë deri vonë në kafene,” tha kamerieri më në moshë.

“Bashkë me ata që nuk duan të shkojnë në shtrat. Bashkë me ata që kanë nevojë për ndriçim natën.”

“Dua të shkoj në shtëpi dhe të futem në shtrat.”

“Unë dhe ti jemi prej dy sojesh të ndryshëm,” tha kamerieri më i moshuar. Ai ishte veshur dhe bërë gati për të vajtur në shtëpi.

“Nuk është vetëm punë rinie dhe besimi te vetja, edhe pse këto janë gjëra shumë të bukura. Çdo natë unë ngurroj ta mbyll kafenenë pasi mund të jetë ndonjë që ka nevojë për të.”

“*Hombre*, ka *bodegas* që rrinë hapur gjithë natën.”

“Ti nuk po kupton. Kjo është një kafene e pastër dhe e këndshme. Me ndriçim të mirë. Ndriçimi është vërtet i kënaqshëm. Ka dhe hije degësh për më tepër.”

“Natën e mirë,” tha kamerieri më i ri në moshë.

“Natën e mirë,” tha tjetri. Ndërsa mbyllte dritat, ai vazhdoi të bisedonte me veten. Ndriçimi sigurisht që ka rëndësi, por është e domosdoshme që vendi të jetë i pastër dhe i këndshëm. Muzikën s’ke ç’e do. Sigurisht që s’ke ç’e do. E as mund të rri me dinjitet para një klubi pavarësisht se veç këtë mundësi të jep ajo orë e natës. Nga çfarë kishte frikë? Nuk ishte as frikë as droje. Ishte një

hiç të cilin ai e njihte fare mirë. Ish veç një hiç dhe njeriu është një hiç po aq. Kaq ishte dhe ndriçimi ishte e vetmja gjë që nevojitej, si dhe njëfarë pastërtie dhe rregulli. Disa e jetonin nga brenda dhe kurrë nuk ia ndjenin praninë, por ai e dinte se gjithçka ish *nada y pues nada y nada y pues nada*. *Nada* jonë që je në *nada*, *nada* qoftë emri yt *nada* mbretëria jote u *nada* vullneti yt si në *nada* ashtu dhe në *nada*. *Nada* tonë të përditshme falna sot dhe *nada* tona siç u *nada* ne *nada* tanë dhe mos na *nada* në *nada*, por na çliro nga *nada*; *pués nada*. Të falemi hiç, hiçplot, hiçi është me ty. Ai buzëqeshi dhe mbajti hapin para një klubi që mbante ndezur makinën për bluarje me presion të kafes.

“Ç’do pish?” pyeti banakieri.

“*Nada*.”

“*Otro loco mas*,” tha banakieri dhe ktheu krahët.

“Një gotë të vogël,” tha kamerieri.

Banakieri ia mbushi.

“Ndriçimi është vërtet i madh dhe i këndshëm, por klubi ka pluhur,” tha kamerieri.

Banakieri e pa, por nuk u përgjigj. Ishte shumë vonë për të këmbyer fjalë.

“Do një tjetër *copita*?” pyeti banakieri.

“Jo, faleminderit,” tha kamerieri dhe doli. Nuk i pëlqenin klube e *bodegas*. Një kafene e pastër dhe me ndriçim të mirë është tjetër gjë. Tani, pa e vrarë më shumë mendjen, do të shkonte në shtëpi, drejt e në dhomën e tij. Do shtrihej dhe pastaj, ndaj të gdhirë, do ta zinte gjumi. Në fund të fundit, thosh ai me vete, me gjasë është veç pagjumësi. Shumë duhet ta kenë./exlibris.al

[Përktheu nga origjinali: Edon Qesari]

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Ballkani tregon fuqinë ndaj kampionëve, Prishtina mposhti Feronikelin

Ballkani ka treguar edhe një herë se do të jetë pretendenti kryesor për titull të kampiones në Superligë. Të përzgjedhurit e Ismet Munishit e mposhten kampionen në fuqi, Dritën. Ndërsa Prishtina mori pikët maksimale nga përballja me Feronikelin

## Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Skuadra e Ballkanit konfirmoi edhe një herë se jo rastësisht është lidere e Superligës, duke e mposhtur të mërkurën kampionen në fuqi, Dritën nga Gjilani (2-0). Në minutën e 20-të, Mirlind Daku dëshmoi formën e lartë duke shënuar për 1-0. Katër minuta me vonë, Drita mbeti pa një lojtar pasi gjyqtari kryesor e përjashtoi nga loja, Ilir Blakçorin. Gjyqtari përjashtoi me karton të kuq edhe trajnerin e Ballkanit, Ismet Munishi. Në minutën e 75-të, Daku realizoi edhe golin e dytë dhe të 14 në këtë kampionat. Pas kësaj ndeshje, Ballkani përforcon pozitën e parë me 19 pikë, derisa



Drita është e katërta me 10 pikë. FC Prishtina ka marrë tri pikë shumë të vlefshme në ndeshjen kundër Feronikelit në Drenas, pasi fitoi me rezultat 1-2. Gentian Muça shënoi në pjesën e parë për epërsinë e kryeqytetasve 0-1, por vendasit

në fillim të pjesës së dytë e barazuan rezultatit me golin e shënuar nga Mendurim Hoti. Fitoren Prishtinës ia siguroi mesfushori Endrit Krasniqi, i cili realizoi nga penalltia pak minuta para fundit të ndeshjes (1-2). "Nikli" vazhdon serinë e

SUPERLIGA		
Feronikeli - Prishtina		1-2
Ballkani - Drita		2-0
Gjilani - Trepça '89		0-0
Besa - Llapi		2-2
Drenica - Arbëria		0-1
Tabela		
		PIKË
1. Ballkani	7	19
2. Prishtina	6	11
3. Arbëria	7	11
4. Drita	5	10
5. Gjilani	7	10
6. Trepça '89	7	8
7. Drenica	7	8
8. Feronikeli	7	6
9. Besa	7	4
10. Llapi	6	2

LIGA E PARË	
Grupi A	
Liria - Dukagjini	1-1
Vëllaznimi - Drenasi	1-0
Vushtrria - Malisheva	1-1
Istogu - Onix	2-0
A&N - Trepça	4-0
Grupi B	
Ramiz Sadiku - Ulpiana	2-1
Flamurtari - 2 Korriku	3-1
Dardana - Ferizaj	1-2
Vllaznia - Vitia	1-3
Kika - KEK-u	1-0

rezultateve negative, derisa trajneri Klodian Duro e regjistron humbjen e parë në krye të kësaj skuadre. Feronikeli është në pozitën e tetë me 6 pikë, kurse Prishtina ngritet në pozitën e dytë me 11 pikë. Të mërkurën është zhvilluar edhe ndeshja mes

Gjilanit dhe Trepçës '89, e cila përfundoi 0-0. Pas xhiros së shtatë, Gjilani zë vendin e pestë me 10 pikë, kurse 89-shi renditet në pozitën e gjashtë me 8 pikë të grumbulluara. Të martën Arbëria e mposhti Drenicën (0-1), kurse Besa luajti baras me Llapi (2-2).

## Ekipi i xhudos rikthehet në gara, synohen medaljet

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Ekipi Olimpik i xhudos do të kthehet në gara, pas tetë muajsh shkaku i pandemisë Covid-19. Shtatë garues do të marrin pjesë në Grand Slamin, që prej 23-25 tetor 2020 mbahet në Budapest të Hungarisë. Grand Slami i Budapestit është një prej garave të pakta të nivelit të lartë që do të zhvillohen këtë vit dhe që vlejné për pikë olimpikë. Madje kjo është gara e parë kualifikuese që prej shtyrjes së Lojërave Olimpikë "Tokio 2020". Ekspedita e xhudos ka kaluar me sukses sfidën e parë të testimit për Covid-19 nga Instituti Kombëtar Shëndetësor i Kosovës (IKSHPK), ndërsa një ritestim do ta kenë edhe në Budapest. Lajmit për rikthimin e garave i është gëzuar edhe trajneri Driton Kuka, kampion olimpik me Majlinda Kelmendin. Kampionia Olimpikë dhe dy herë kampionia e botës mungon në këtë garë. "Së pari është me



rëndësi që po nisin garat dhe po marrim pjesë me shumicën e ekipit", ka thënë Kuka për uebfaqen zyrtare të KOK-ut. Pavarësisht prej mungesës së gjatë në gara, synimet e xhudos mbeten të njëjta, medaljet. "Shpresoj të kthehemi me medalje. Konkurrenca duket të jetë shumë e fortë, duke i parë emrat e lajmëruar për garë. Në çfarë forme janë garuesit tanë, por edhe të tjerët, tashmë është diçka që duhet parë bazuar edhe në pauzën gati njëvjeçare prej kohës kur kemi zhvilluar gara", ka shtuar Kuka.

Distria Krasniqi (-48 kilogramë), Nora Gjakova (-57 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg), Loriana Kuka (-78 kg), Akil Gjakova (-73 kg) dhe Shigeki Nakamura (-66 kg). Ky i fundit që ka marrë nënshpëtimin e Kosovës do të garojë për herë të parë në një garë të nivelit të tillë, bashkë me Flaka Loxhën. Nakamura në fillim të këtij muaji fitoi medaljen e artë në Kupën Evropiane të mbajtur në Dubrovnik të Kroacisë. "Për Flakën e Nakamurën duhet ta shohim ku e kanë vendin në nivele të tilla. Gara është pasqyra", vlerëson Kuka. 459 garues nga 69 shtete janë paraqitur për pjesëmarrje, bazuar në të dhënat e tanishme të Federatës Ndërkombëtare të Xhudos. Ekipi Olimpik i xhudos që prej fillimit të pandemisë ka marrë pjesë në pesë kampe, shpenzimet e të cilave janë mbuluar nga KOK-u.

## Në Komoran nis ndërtimi i stadiumit sintetik

**DRENAS, 21 TETOR** - Komunës së Drenasit i shtohet edhe një terren sportiv sintetik. Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, zëvendësministri Halil Matoshi dhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë vënë gurthemelin e stadiumit sintetik në Komoran, projekt kapital që tejkalon shumë prej gjysmë milioni euro dhe që pritet të përfundojë brenda dy vjetëve. Ministrja Dumoshi ka treguar se bashkë me kryetarin Lladrovci kanë bërë homazhe te shtatorja e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, për të vazhduar te stadiumi "Rexhep Rexhepi" i cili është financuar nga MKRS-ja. Dumoshi ka thënë se kanë biseduar për projektet që janë në realizim dhe ato që kanë qenë në plan të realizohen në të ardhmen, por për shkak të shkurtimeve buxhetore si pasojë e pandemisë, projektet që do të



realizohen janë vetëm ato që kanë vazhdimësi, ndërsa projektet e reja do të shtyhen për një kohë. "Në Drenas e kudo në Kosovë, ka përmirësim të dukshëm të infrastrukturës sportive dhe kulturore dhe kjo na gëzon si ministri, meqenëse ky është synimi i të gjitha investimeve", ka thënë ministrja Dumoshi. Kryetari Lladrovci ka falënderuar ministrin dhe MKRS-në për përkrahjen dhe përkrahjen për projektet që janë në dobi të qytetarëve të Komunës së Drenasit. Ai ka thënë se MKRS-ja dhe komuna kanë një bashkëpunim të shkëlqyer.

## Muriqi: Paraqitje dhe rezultat madhështor

**ROMË, 21 TETOR** - Sulmuesi i përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, ka debutuar për skuadrën e Lazios në Ligën e

Kampionëve, derisa klubi italian në "Olimpico" e mposhti Borussia Dortmundin (3-1). Muriqi u inkuadrua në lojë në

minutën e 67-të në vend të Joaquim Correas dhe pati paraqitje të mirë, kurse bëhet lojtari i parë i "dardanëve" që luan

në grupet e Ligës së Kampionëve. "Paraqitje dhe rezultat madhështor. Forza Lazio", ka shkruar Muriqi në "Instagram".



## Presidenti Meta takon kampionin Robin Krasniqi: Sukses i tij është frymëzues

TIRANË, 21 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, pati mëngjesin e sotëm një mysafir special. Ai ishte kampioni i ri i botës në boks,

në versionin WBA dhe IBO, Robin (Haxhi) Krasniqi, që ka bërë krenar së fundmi gjithë shqiptarinë. Nëpërmjet një fotoje të postuar në faqen

zyrtare, ku shfaqej në krah të Krasniqit, me 2 brezat e artë, kreu i shtetit shqiptar është ndier krenar për djaloshin nga Juniku. "Kënaqësi e veçantë të

takoja kampionin e ri të botës në boks në versionin WBA dhe IBO, Robin Krasniqi. Puna, përkushtimi dhe sakrificat e tij drejt suksesit, janë frymëzuese!



## Kosova vazhdon përgatitjet për ndeshjen ndaj Turqisë dhe Holandës

PRISHTINË, 21 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e fermave në futboll po përgatitet për dy ndeshjet e radhës kualifikuese për Evropianin 2021 kundër Turqisë dhe Holandës. Pas fitores kundër Estonisë në muajin e kaluar, atmosfera në ekip është mjaft e mirë, derisa optimizmi për të nxjerrë rezultat pozitiv edhe në duelin me kombëtaren turke është i madh.

Stërvitjen e "dardaneve" nga afër e ndoqi edhe sekretari i përgjithshëm i FFK-së, Eroll Salihu. "Dardanet" do të udhëtojnë sot (e enjten) në Antalia, ku të premtën do të ballafaqohen me Turqinë në Manavgat, derisa më pas më 27 tetor do të luajnë në stadiumin "Fadil Vokrri" kundër Kombëtares së Holandës, e cila është një prej ekipeve më cilësore në futbollin e vajzave. "Edhe ndeshja e parë kundër Turqisë nuk ka qenë e lehtë, por gjithmonë duke pasur besim në grupin e lojtareve dhe duke pasur parasysh se kemi edhe dy stërvitje të tjera para ndeshjes, shpresoj se do të



përgatitemi mirë dhe do të kemi një paraqitje të mirë. Para vetes i kemi dy ndeshje të vështira, por fillimisht do të përqendrohemi te dueli me Turqinë, ku shpresojmë për rezultat pozitiv, kurse më pas do të mendojmë për sfidën e vështirë me holandezet. E dimë nivelin e tyre, por nuk do ta

nënvlerësojmë veten as para tyre dhe do të përpiqemi t'u rezistojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Por, fillimisht duhet të japim më të mirën tonë në Turqi, ngase fitorja atje do të na jepte motiv shtesë për duelin me holandezet", ka thënë futbollistja Edona Kryeziu.

## Hamiltoni: Do të jetë i vështirë çasti kur të pensionohem

LONDËR, 21 TETOR - Lewis Hamiltoni ka folur për të ardhmen e tij, ndërkohë që kontrata me makinën e Mercedesit skadon në fund të këtij sezoni. Piloti britanik është drejt fitimit të titullit të 7-të kampion bote në Formula 1, ndërkohë që 10 ditë më parë barazoi rekordin e 91 fitoreve në Formula 1 të Michael Schumacherit. "Më pëlqen kjo që bëj, më pëlqejnë sfidat, më pëlqen të dueloj, më pëlqen të shoh në pasqyrat e makinës. Më pëlqen ky sport, konkurrenca, atmosfera. Do të jetë i vështirë momenti kur ta vendos tërheqjen time nga ky sport", ka thënë Hamilton. "Mendoj se kam nga pas skuadrën më të mirë që mund të imagjinoja. Ndihej i frymëzuar nga kjo makinë. Kush mendon se pas kaq shumë kohësh do të isha mërzhitur



duke pilotuar këtë makinë gabon. mirënjohës të gjithëve", ka deklaruar Hamiltoni. Ka harmoni mes nesh dhe i jam

### SHKURT

#### Anulimi i 258 ndeshjeve solli një humbje kolosale për skuadrat dhe NBA-në

NBA ka humbur gati 700 milionë dollarë si pasojë e anulimit të 258 ndeshjeve të sezonit të rregullt. Kampionati u ndërpre në mars për shkak të pandemisë Covid-19 dhe rinisi në fund të korrikut, me sistem grumbullimi të 22 nga 30 skuadrave. Pesë ekipet që kanë pësuar humbjet më të mëdha financiare janë LA Lakers, New York Knicks, Golden State Warriors, Houston Rockets dhe Boston Celtics. Ekipi i Golden State është ai që gjeneron më shumë të ardhura nga ndeshjet në fushën e tij, gati 6 milionë dollarë nga shitja e biletave. Më pas vijnë Lakersat me 5.6 milionë dhe Knicks me 5.2 milionë dollarë për ndeshje. NBA gjeneron rreth 40 % të të ardhurave nga shitja e biletave dhe të shpenzimeve që bëjnë tifozët në çdo ndeshje.

#### Barça 'blindon' katër futbollistë

Barcelona është përqendruar në rinovimet e kontratave të futbollistëve që konsiderohen të rëndësishëm për të ardhmen. Në këtë mënyrë klubi ka vazhduar bashkëpunimin me katër futbollistë. Mbrojtësi Gerard Pique do të jetë pjesë e katalanëve edhe për katër sezonet e ardhshme. Portieri gjerman Marc-Andre ter Stegen ka vendosur të qëndrojë në "Camp Nou" të paktën deri në verën e 2025-s. Firmën mbi kontratë e ka vënë edhe holandezi Frenkie de Jong, i cili iu bashkua katalanëve vetëm verën e kaluar, por tani ka firmosur një zgjatje të bashkëpunimit deri në verën e 2026-s. I fundit në radhën e atyre që kanë hedhur firmën mbi kontratë, ka qenë mbrojtësi francez Lenglet, i cili do të jetë i lidhur me Barcelonën deri në verën e 2026-s.

#### Sarri në listën e Romës dhe të Fiorentinës

Dy skuadra të mëdha italiane e duan Maurizio Sarri. Trajnerin italian shumë shpejt mund ta shikojmë në stolin e një skuadre, pasi në adresë të tij kanë ardhur disa oferta. Bëhet fjalë për Romën dhe Fiorentinën. Këto të fundit nuk kanë pasur rezultate dhe aq të mira dhe kjo i ka bërë drejtuesit të mendojnë për ndryshimin e trajnerit dhe i pari në listë për ta marrë drejtimin e kësaj skuadre është Maurizio Sarri.

#### Lampard: Rëndësi ka që nuk pësuam gol

Chelsea-Sevilla u mbyll pa fitues (0-0). Përballja e Ligës së Kampionëve dhuroi pak raste për gol dhe shumë duele të forta mes dy ekipeve, që e nisën me nga një pikë sezonin e ri. Trajneri i "Bluve të Londrës", Frank Lampard, foli shkurt pas barazimit në shtëpi. "Jam shumë i kënaqur nga qëndrimi dhe paraqitja e ekipit tim. Djemtë bënë një reagim të mirë pas takimit të së shtunës në kampionat. U treguam të aftë që e mbajtëm portën të paprekur kundër një prej skuadrave më të mira evropiane, një bazë nga e cila duhet të rinisemi", ka thënë Lampardi.

## Pritet shkarkimi i Tuchelit, PSG-ja mendon për Allegrin

Për momentin është trajneri më i kërkuar nga ekipet e mëdha. Në Itali flitet shumë për një kalim të mundshëm te Roma dhe Lazio, ndërkohë që në Angli janë

Manchester Unitedi dhe Chelsea që kanë shfaqur interes. Po flasim për Max Allegrin, i cili shumë shpejt mund të rikthehet në krye të një ekipi. Në fakt në orët e fun-

dit destinacioni më i mundshëm është Parisi. Leonardo gjithmonë ka qenë një mbështetës i tij për shkak të aventurës shumë pozitive te Juventusit. Raporti mes

Tuchelit dhe drejtorit sportiv të parisienëve është gjithnjë e më i tensionuar, pas humbjes kundër Manchester Unitedit. PSG-ja është në kërkim të një trajneri me

përvojë që është i aftë që të menaxhojë një grup shumë cilësor futbollistëve. Allegrin shihet si trajneri perfekt për situatën që po kalon klubi francez.



Sot më datë 22 tetor bëhen njëmbëdhjetë vite pa ty

## NAILE SHPATI

Të jetosh në zemrat e atyre që i le pas do të thotë të mos vdesësh kurrë. Po na mungon shumë.

**Të përkujtojnë:** *Bashkëshorti Dini me fëmijët Anita, Arbenita, Eronita djali Shëndriti me gruan, si dhe halla Shehrija me fëmijët.*



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "EPE Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810140434.
- ▶ Rilinda Bërbatovci, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën e shkollës "7 Shtatori" Prishtinë.
- ▶ SH.P. "OK" SH.P.K. me numër Unik të Biznesit 810604000, nr. fiskal 600026536 dhe nr. të TVSH-së, 330041468 ka vendosur për zvogëlimin e kapitalit nga 500.000.00 në shumën 250.000.00 Prizren.
- ▶ "Business Services" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70775166 dhe nr. fis. 600707931.
- ▶ "Paper" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. identifikues 810799942 dhe nr. biz. 70617986.
- ▶ "AJ Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71004406 dhe me nr fis. 601035901.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**

### CONTRACT AWARD NOTICE

The United States of America, acting through the Millennium Challenge Corporation ("MCC") and the Government of Kosovo (the "Government" or "GoK") have entered into a Millennium Challenge Threshold program agreement for Millennium Challenge Account assistance to help facilitate poverty reduction through economic growth in Kosovo (the "Threshold program agreement") in the amount of approximately 49 million USD ("MCC Funding"). The Government, acting through Millennium Foundation of Kosovo (the "MCA Entity"), intends to apply a portion of the MCC Funding to eligible payments under a contract for which procurement activities were issued. Any payments made by the MCA Entity under the proposed contract will be subject, in all respects, to the terms and conditions of the Threshold program agreement and related documents, including restrictions on the use and distribution of MCC Funding. No party other than the Government and the MCA Entity shall derive any rights from the Threshold program agreement or have any claim to the proceeds of MCC Funding. The Threshold program agreement and its related documents can be found on the MCC website ([www.mcc.gov](http://www.mcc.gov)) and on the website of the MCA Entity <https://millenniumkosovo.org/>.

Activity Ref No: IC/ MFK/2020/05

Activity Name: Selection of an individual consultant for project support specialist

Procurement Type & Method: Individual Consultant

Contract No: IC/ MFK/2020/05

Contract Title: Individual consultant for project support specialist

Awarded To: Nora Cimili

Price: € 23,596.77

Date of Award: 28 July 2020 (Effective date 17 August 2020)

Duration: 30 September 2021

Scope (Summary): The Project Specialist, Energy efficiency, under the supervision of the Director of Energy, is responsible for the daily execution, monitoring, and supervision of relevant activities and sub-activities supporting the Reliable Energy Landscape Project, with the main focus on the 2 activities: Pilot incentives for household energy efficiency and District Heating Metering to ensure consistency with established work plans and implementation guidelines.

Activity Ref No: IC/MFK/2020/001

Activity Name: Selection of an individual consultant for energy open data

Procurement Type & Method: Individual Consultant

Contract No: IC/MFK/2020/001

Contract Title: Individual consultant for energy open data

Awarded To: Lorëz Qehaja

Price: € 6000.00

Date of Award: 28 July 2020 (Effective date 01 September 2020)

Duration: 27 October 2020

Scope (Summary): The main objective of this assignment is to (1) clean and structure the datasets from private/public entities of the energy sector in Kosovo in open data readable formats such as XLS or CSV, in accordance with the needs of these entities, (2) develop and deliver the data portion of the Energy Efficiency Dig Data Stakeholders Workshop, (3) develop a manual/guidebook for the Dig Data Challenge on Energy Efficiency, (4) develop a data analysis illustration to be used in the application form of the Dig Data Challenge on Energy Efficiency. A primary focus of this assignment is to build an open machine-readable database of the data available in the energy sector, from entities that collect and generate analysis on this data, in order for civil society, the private sector, individuals and other related stakeholders to obtain and analyze this data

Activity Ref No: IC/MFK/2020/013

Activity Name: Private Sector Development Specialist

Procurement Type & Method: Individual Consultant

Contract No: IC/MFK/2020/001

Contract Title: Private Sector Development Specialist

Awarded To: Besnik Haziri

Price: € 9,668.76

Date of Award: 08 September 2020 (Effective date 16 September 2020)

Duration: 16 Mars 2021

Scope (Summary): The Project Specialist, Energy efficiency, under the supervision of the Director of Energy, is responsible for the daily execution, monitoring, and supervision of relevant activities and sub-activities supporting the Reliable Energy Landscape Project, with the main focus on the 2 activities: Pilot incentives for household energy efficiency and District Heating Metering to ensure consistency with established work plans and implementation guidelines.

Activity Ref No: RFP / MFK / 026

Activity Name: Quality Control Supervising Consultant for DHM Implementation

Procurement Type & Method: QCBS

Contract No: RFP / MFK / 026

Contract Title: Quality Control Supervising Consultant for DHM Implementation

Awarded To: IVT Consult Ltd.

Price: \$403,750.00

Date of Award: 03 August 2020 (Effective date 07 September 2020)

Duration: 30-Sep-2021, unless otherwise agreed upon by both parties.

Scope (Summary): The Supervising Consultant team will be responsible for conducting initial audits of manuals, studies, plans and reports; the oversight of the commissioning the DHM works to ensure that the works are implemented and goods supplied in accordance with the designs, specifications and terms and conditions of the procurement contracts, including environmental, health and safety considerations; and the oversight of TA, trainings and tariff design.

### SHPLLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja Shoqërore "JATEX" Gjakovë

Ndërmarrja Shoqërore "Jatex" Gjakovë e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, **SHPLLË** këtë:

### FTESË PËR OFERTË

PËR SHITJEN E MBETJEVE METALIKU -HEKURISHTAVE, MATERIALEVE TE ALUMINIT DHE GYPAVE TE ZINKTUAR

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja Shoqërore "JATEX"

ADRESA POSTARE: Gjakovë

#### I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Mbetje te ndryshme metalike - Hekurishtave,
2. Mbetjeve nga alumini si dhe
3. Gypave te zingtuar

#### II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresën.  
Oferta duhet të përmbajë çmimin me TVSH për të tre (3) llojet e materialeve veç e veç ku për dy llojet e para çmimi duhet të jete ne euro për kg kurse për gypat e zingtuar çmimi duhet të jete për metër gjatësi, oferta duhet të jete shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

#### III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 22.10.2020 deri me 26.10.2020 prej orës 10:00h deri në orën 13:00h përmes personit kontaktues z. Naser Bordoniqi, nr. tel mob. 044616800.

#### IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES :

1. Çmimi më i lartë i ofruar për mbetje metalike

#### V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **26.10.2020** nga ora **13<sup>00</sup>** deri në orën **14<sup>00</sup>** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **26.10.2020** në ora **14<sup>10</sup>** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08;

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.

### SHPLLJE PËR SHITJE

Ndërmarrja Shoqërore "VIRXHINIA" Gjakovë

Ndërmarrja Shoqërore "Virxhinia" Gjakovë e cila është në Administrim të Drejtpërdrejt të AKP-së, **SHPLLË** këtë:

### FTESË PËR OFERTË

PËR SHITJEN E MBETJEVE METALIKU -HEKURISHTAVE

EMRI ZYRTAR: Ndërmarrja Shoqërore "VIRXHINIA"

ADRESA POSTARE: Gjakovë

#### I. LËNDA E KONTRATËS;

Autoriteti kontraktues ka për qëllim shitjen e materialeve si vijon:

1. Mbetje të ndryshme metalike - Hekurishtave,

#### II. KUSHTET E OFERTIMIT:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit, numrit fiskal, certifikata e TVSH-se, numrin e telefonit kontaktues dhe adresën.  
Oferta duhet të përmbajë çmimin me TVSH, oferta duhet të jetë shume e qartë dhe të përfshijë të gjitha detajet e kërkuara, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

#### III. VIZITA E MATERIALEVE

Palët e interesuara, materialet e larte cekura mundë ti shikojnë prej datës 22.10.2020 deri me 26.10.2020 prej orës 10:00h deri në orën 13:00h përmes personit kontaktues z. Agim Sefa, nr. tel mob. 044729444.

#### IV. KRITERET PER DHENJEN E KONTRATES :

1. Çmimi më i lartë i ofruar për mbetje metalike - hekurishta

#### V. AFATI KOHOR DHE VENDI PER DOREZIMIN E OFERTAVE

Ofertat finale të cilat duhet të jenë në zarf të mbyllur, duhet të dërgohen me datën **26.10.2020** nga ora **13<sup>00</sup>** deri në orën **14<sup>00</sup>** në adresën e mëposhtme: Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08.

Ofertat do të hapen me datë **26.10.2020** në ora **14<sup>10</sup>** në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rr. Agim Ramadani nr.08;

VI. Përfaqësuesit legjitim të ofertuesve, mund të marrin pjesë me rastin e hapjes së ofertave.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohemi*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvaqshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.

4<sup>99</sup>€



Sh. B. Armagedoni

Linga e heshtjes

Bujar Salihu

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES  
(poezi)



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema kadareane*. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku nja tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuara e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.


Dr. Arben Fetoshi

4<sup>99</sup>€



Triptikon arbëresh

Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikeja, ikonikja)

-  S. GIORGIO ALB. M buzati
-  VACCARIZZO ALB. Vakarici
-  S. COSMO ALB. Strighari
-  MACCHIA ALB. Maqi